



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

RAPORTET E MONITORIMIT

12 - MUJORI VITI 2019

Programet Buxhetore:

- 1. Planifikim Administrim, Menaxhim**
- 2. Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë**
- 3. Arti dhe Kultura**

RELACION

MBI MONITORIMIN E SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR 8-MUJORIN E VITIT

2019

Në zbatim të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, të Udhëzimit të Ministrit të Financave, nr.9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit Plotësues nr.1 datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, paragrafi V “Monitorimi” si dhe Udhëzimi nr.22 datë 17.11.2016 “Për Procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”, Ministria e Kulturës, për 12-mujorin e vitit 2019, ka menaxhuar dhe vlerësuar me përparësi të veçantë procesin e monitorimit të zbatimit të fondeve buxhetore.

Për vitin 2019 detajimi i buxhetit është mbështetur në Programin Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 si dhe në prioritetet e përcaktuara në Programin e Qeverisë.

Buxheti i akorduar në fillim të vitit 2019 ka pësuar ndryshime gjatë vitit si rezultat i përfitimit të fondeve buxhetore nga VKM, nëpërmjet rishpërndarjeve të fondeve dhe Akteve Normative sipas tabelës më poshtë:

në 000/lekë

Programet	Artikulli	Buxheti Fillestar	Fondi I Vecante	Shtesa referuar ligjit 8097 dt 21.03.1996	Shtesa me VKM	Shtesa/Pakesi me nga Akti Normativ	Transferime	Plani me ndryshime
Planifikimi, Menaxhim dhe Administrim	Shpenzime personeli	115,276	-	-	-	-	(11,000)	104,276
	Shpenzime korrente	45,000	600	54	-	-	11,000	56,654
	Shpenzime Kapitale	-	-	-	-	-	-	-
	Totali	160,276	600	54	-	-	-	160,930
Trashegimia dhe Muzete	Shpenzime personeli	298,924	-	-	-	-	(7,402)	291,522
	Shpenzime korrente	218,267	1,300	-	15,120	1,146	7,402	243,235
	Shpenzime Kapitale	5,000	-	-	30,000	30,000	-	65,000
	Totali	522,191	1,300	-	45,120	31,146	-	599,757
Arti dhe Kultura	Shpenzime personeli	546,800	-	-	-	-	(37,841)	508,959
	Shpenzime korrente	236,600	1,600	-	10,000	-	37,841	286,041
	Shpenzime Kapitale	700,000	-	-	-	20,000	-	720,000
	Totali	1,483,400	1,600	-	10,000	20,000	-	1,515,000
TAVANET MK	Shpenzime personeli	961,000	-	-	-	-	(56,243)	904,757
	Shpenzime korrente	499,867	3,500	54	25,120	1,146	56,243	585,930
	Shpenzime Kapitale	705,000	-	-	30,000	50,000	-	785,000
	Totali	2,165,867	3,500	54	55,120	51,146	-	2,275,687

Sikurse vërehet edhe në tabelën e mësipërme Buxheti ka pësuar këto ndryshime referuar programeve të MK:

1. Programi Planifikim, Menaxhim dhe Administrim

Shpenzimet korrente u shtuan në vlerën prej 600 mijë lekë nga fondi i veçantë dhe 54 mijë lekë referuar ligjit nr.8097 datë 21.03.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, i ndryshuar.

Gjithashtu shpenzimet korrente u shtuan në vlerën prej 11,000 mijë lekë nga krijimi i fondeve të lira si rezultat i mosplotësimit të vendeve vakante nga DAP për aparatin e MK, me qëllim përdorimin e tyre për mbulimin shpenzimeve administrative dhe për shlyerjen vendimesh gjyqësore etj.

2. Programi Trashëgimia dhe Muzetë

Për këtë program, shpenzimet korrente u shtuan në vlerën prej 1.300 mijë lekë nga fondi i veçantë, në vlerën prej 15,120 mijë lekë nëpërmjet VKM nr.678 datë 16.10.2019 *”Për një shtesë fondesh, në buxhetin e miratuar për vitin 2019, për financimin e aktiviteteve që do të organizohen me rastin e 75-vjetorit të Çlirimit të vendit”*, si dhe në vlerën prej 1,146 mijë lekë nga Akti Normativ nr.2 datë 02.10.2019 për përballimin e shpenzimeve të 100-të vjetorit të parlamentarizmit.

Gjithashtu këto shpenzime u shtuan në vlerën prej 7,402 mijë lekë nga krijimi i fondeve të lira si rezultat i mosplotësimit të vendeve vakante në institucionet e varësisë, për mbulimin e shpenzimeve administrative për institucionet e varësisë si dhe për realizimin e projekteve me qëllim përmbushjen e prioritetëve të sistemit të Kulturës.

Përsa i përket shpenzimeve kapitale, u shtuan në vlerën prej 30,000 mijë lekë nëpërmjet VKM nr.496 datë 16.07.2019 *”Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e 2019 për caktimin e organit përgjegjës për përdorimin e fondeve të mbledhura nga donator të ndryshëm për rindërtimin e shtëpive të dëmtuara nga tërmeti për Restaurimin e Muzeut “Mësonjëtorja e Parë Shqipe”*.

Ndërsa me Aktin Normativ nr.2 datë 02.10.2019, Ministrisë së Kulturës iu shtua tavanin prej 30,000 mijë lekë përdorimin e financimit të huaj në vitin 2019.

3. Programi Arti dhe Kultura

Shpenzimet korrente u shtuan në vlerën prej 1.600 mijë lekë nga fondi i veçantë, në vlerën prej 10,000 mijë lekë nëpërmjet VKM nr.678 datë 16.10.2019 *”Për një shtesë fondesh, në buxhetin e miratuar për vitin 2019, për financimin e aktiviteteve që do të organizohen me rastin e 75-vjetorit të Çlirimit të vendit”* si dhe në vlerën prej 37,841 mijë lekë nga krijimi i fondeve të lira si rezultat i mosplotësimit të vendeve vakante në institucionet e varësisë, për mbulimin e shpenzimeve administrative për institucionet e varësisë si dhe për realizimin e projekteve me qëllim përmbushjen e prioritetëve të sistemit të Kulturës.

Gjatë vitit 2019 krahas ndjekjes së planit me qëllim përgjigjes së nevojave të sistemit të kulturës, rëndësi të veçantë i është dhënë dhe zbatimit të buxhetit si nga Aparati i MK dhe nga institucionet e varësisë për realizimin e objektivave dhe produkteve të planifikuara për Kulturën. Më poshtë prezantojmë realizimin e buxhetit për 12-mujorin e vitit 2019, ndarë sipas programeve dhe zërave ekonomikë:

-Realizimi i fondeve buxhetore sipas programeve

në 000/lekë

Nr.	Programet	Plani 12 mujorit 2019		Realizimi 12 mujorit 2019		Realizimi ne (%) ndaj Planit perfundimtar te vitit 2019
		Ne mije leke	Struktura ne %	Ne mije leke	Struktura ne %	
1	Planifikim, Menaxhim, Administrim	160,930	7.17%	147,271	6.92%	91.51%
2	Trashëgimia Kulturore dhe Muzete	569,757	25.37%	522,928	24.57%	91.78%
3	Arti dhe Kultura	1,515,000	67.46%	1,458,502	68.52%	96.27%
	Totali	2,245,687	100.0%	2,128,700	100%	94.79%

Siç vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti në total është realizuar në masën 94.79% ndaj planit vjetor. Referuar planit vjetor rreth 67.46 % të totalit të shpenzimeve e zë zëri i shpenzimeve të programit “Arti dhe Kultura” buxheti i të cilit është realizuar në masën 96.27%, ndjekur nga programi "Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë" shpenzimet e të cilit zënë rreth 25.37% , të cilat janë realizuar në masën 91.78% si dhe rreth 7.17% të totalit të shpenzimeve e zë zëri i shpenzimeve të programit “Planifikim, Menaxhim, Administrim” buxheti i të cilit është realizuar në masën 91.51% .

-Realizimi i fondeve buxhetore sipas zërave ekonomikë

në 000/lekë

Gr.	Artikulli	Emertimi	Plani 12 mujorit 2019		Realizimi 12 mujorit 2019		Realizimi ne (%) ndaj Planit perfundimtar te vitit 2019
			Ne mije leke	Struktura ne %	Ne mije leke	Struktura ne %	
12	600-601	Shpenzime Personeli	904,757	40.29%	890,932	41.85%	98.47%
12	602-606	Shpenzime Korrente	585,930	26.09%	486,103	22.84%	82.96%
12	230-231	Shpenzime Kapitale	755,000	33.62%	751,665	35.31%	99.56%
	Totali		2,245,687	100%	2,128,700	100%	94.79%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti në total është realizuar në masën 94.79% ndaj planit për 12-mujorin e 2019 nga ku:

-Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 40.29% të totalit të planifikuar dhe janë realizuar në masën 98.47% ndaj planit vjetor dhe pjesa tjetër e mosrealizimit ka ardhur si rezultat i mosplotësismit të vendeve vakante.

-Shpenzimet korrente zënë rreth 26.09% të totalit të planifikuar dhe janë realizuar në masën 82% ndaj planit vjetor nga ku përkatësisht:

Këto shpenzime janë përdorur kryesisht për realizimin e shërbimeve të domosdoshme nga ana e institucioneve të MK, si shpenzime operative (për ujë, drita, postë, telefon), shpenzime të mirmbajtjes, shpenzime (udhëtime dhe dieta) për përballimin e lëvizjeve të specialistve të fushës në objekte që janë në kujdestari të institucioneve të MK, për pagesën e projekteve artistike, për pagesën e kuotizacioneve në bazë të marrëveshjeve që ka MK me organizata ndërkombëtare etj. Realizimi për 12-mujorin nuk është në nivelet e pritshme si rezultat edhe situatës së krijuar nga tërmeti i 26- nëntorit.

-Ndërsa shpenzimet kapitale zënë rreth 33.62% të totalit të planifikuar dhe janë realizuar në masën 99.56% ndaj planit vjetor.

Përsa i takon investimeve për vitin 2019, Ministria e Kulturës është përqëndruar përkatësisht në këto projekte:

1-Rikonstruksioni i Teatrit të Operës dhe Baletit, në proces

Projekt që ka startuar që në vitin 2017, ka vijuar punimet për vitin 2019 dhe me qëllim përmbushjen e prioriteteve të qeverisë pritet të mbyllet plotësisht në vitin 2020.

Nga vlera totale e këtij investimi prej 1,125 milion lekë, deri në fund të vitit 2019 është realizuar 995.3 milion lekë ose 88 % e vlerës së këtij projekti.

2-Blerje pajisje për Teatrin e Operës dhe Baletit

Nga vlera totale e këtij investimi prej 320.3 milion leke, deri në fund të vitit 2019 është realizuar 269.3 milion lekë ose 84% e vlerës së këtij projekti dhe pjesa e mbetur është planifikuar të mbyllet në vitin 2020.

3-Hartimi i Projektit për Rikonstruksionin e Muzeut Historik Kombëtar

Projekt më vlerë totale 40 milion lekë që startoi në vitin 2018 nga ku u realizua 35 milion lekë, dhe diferenca e mbetur prej 5 milion lekë u realizua në vitin 2019 duke përmbyllur me sukses projektin.

4-Restaurim i Muzeut "Mësonjëtorja e parë Shqipe"

Fondi për këtë investim iu shtua Ministrisë së Kulturës me VKM nr.496 dt 16.07.2019 "Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e 2019 për caktimin e organit përgjegjës për përdorimin e fondeve të mbledhura nga donator të ndryshëm për rindërtimin e shtëpive të dëmtuara nga tërmeti " projekt i cili u finalizua plotësisht.

Krahas Buxhetit të akorduar për vitin 2019, Ministria e Kulturës ka realizuar shpenzime dhe nga të ardhurat jashtë limitit për të tre programet e MK përkatësisht:

në 000/lekë

Kodi Program	Programet	Vlera e realizimit të Shpenzimeve korrente nga të ardhurat jashtë limitit	% e realizimit ndaj totalit
01110	Planifikimi, Menaxhim dhe Administrim	16,021	22%
08220	Trashëgimia dhe Muzete	22,570	30%
08230	Arti dhe Kultura	35,783	48%
TOTALI per programet e MK		74,374	100%

Referuar tabelës rreth 48% e shpenzimeve nga të ardhurat jashtë limitit janë kryer nga Programi Arti dhe Kultura në vlerën prej 35,783 mijë lekë konkretisht nga institucionet:

- Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor
- Teatri Kombëtar
- Qendra Kombëtare e Kulturës për Femijë
- Galeria Kombëtare e Arteve
- Teatri Komb. Eksperimental "K.Spahivogli"
- Arkivi Qendror i Filmit
- Aparati MK

Këto shpenzime janë kryer për mbështetjen dhe realizimin e projekteve atistike me qëllim promovimin e artit dhe kulturës.

Ndërsa Programi i Trashëgimisë dhe Muzeve ka realizuar rreth 30% të shpenzimeve nga të ardhurat jashtë limitit në vlerën prej 22,570 mijë lekë nga institucionet si:

- Zyra e Administrimit dhe Koordinimit Butrint
- Qendra e Muzeumeve Berat
- DRKK Shkodër
- DRKK Vlorë
- Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe"

Këto shpenzime janë kryer për mbështetjen dhe realizimin e projekteve atistike me qëllim mbrojtjen, promovimin, edukimin dhe menaxhimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, zhvillimin e rrjetit të muzeve kombëtarë dhe lokalë, parqeve arkeologjike dhe lëvizjen e objekteve të trashëgimisë kulturore.

Gjithashtu, Programi Planifikim, Menaxhim dhe Administrim ka realizuar rreth 22% shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit në vlerën prej 16.021 mijë lekë kryesisht për realizimin projektit Hamleti dhe për realizimin e Projektit Creative Europe, marrëveshje kuadër mes Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për Creative Europe, e nënshkruar në qershor të vitit 2014. Sipas kësaj marrëveshjeje granti përbëhet nga shuma e financimit të BE (50%) dhe 50% e mbetur që e vendos shteti palë.

Granti i akorduar nga BE përdoret për të financuar:

- botime dhe broshura ilustruese e promovuese per Creative Europe.
- Evente rajonale te ndryshme/blerje pajisjesh etj
- Honorare per ekspertet/asistente te programit

Për vitin 2019, drejtuesit e Programeve kanë ndjekur me përgjegjshmëri procesin e realizimit të fondeve buxhetore duke siguruar menaxhimin e buxhetit nëpërmjet:

- a) monitorimit të objektivave bazuar në treguesit e performancës.
- b) si dhe monitorimit të produkteve në sasi dhe vlerë.

1.Programi: “PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM”

Ky program ka për qëllim mbështetjen juridike, financiare dhe me burime njerëzore për zhvillimin e artit dhe kulturës përmes instrumentave ligjorë, institucional e financiarë si dhe objektiv krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm ligjor e institucional për zhvillimin e artit dhe kulturës.

Për fondet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë;

në 000/lekë

Gr.	Programi	Artikulli	Emertimi	Plani 12 mujorit 2019		Realizimi 12 mujorit 2019		Realizimi ne (%) ndaj Planit perfundimtar te vitit 2019
				Ne mije leke	Struktura ne %	Ne mije leke	Struktura ne %	
12	01110	600-601	Shpenzime Personeli	104,276	64.80%	99,029	67.24%	94.97%
12	01110	602-606	Shpenzime Korrente	56,654	35.20%	48,242	32.76%	85.15%
12	01110	230-231	Shpenzime Kapitale					
		Totali		160,930	100.00%	147,271	100.00%	91.51%

Nga të dhënat rezulton se buxheti është realizuar në masën 91.51% ndaj planit vjetor, nga ku shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 64.80% të totalit dhe janë realizuar në masën 94.97% ndaj planit vjetor. Shpenzimet korrente zënë rreth 35.20% të totalit dhe janë realizuar në masën 85.15% ndaj planit vjetor.

Fondet buxhetore të këtij programi janë organizuar në dy produkte si planifikimi dhe realizimi i të cilave, rezulton si më poshtë.

Për sa i përket **produktit me kod 91201AA “Akte ligjore/nënligjore të miratuara”** është kostuar duke ngarkuar shpenzimet e personelit të aparatit të MK, shpenzime të cilat realizohen me qëllim hartimin dhe miratimin e akteve të reja ligjore dhe nënligjore në përputhje me programin e qeverisë dhe detyrimeve që rrjedhin nga MSA sipas fushës së veprimtarisë së MK. Ky produkt ishte planifikuar për 12-mujorin e vitit 2019 të realizohej në sasinë prej 57 akte referuar Programit Përgjithshëm Analitik të Projektakteve miratuar me vendimin nr.764, datë 27.12.2018.

Brënda planit Analitik të 2019 janë miratuar në total 25 akte ndërsa jashtë planit janë miratuar 12 akte renditur si më poshtë:

-Vendimi nr.788, datë 26.12.2018 “Për përbërjen, kompetencat, mënyrën e funksionimit dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Muzeve”.

Ky akt rregullon kuadrin ligjor të organit kolegjal Këshilli Kombëtar Muzeve ku përcaktohen rregullat mbi përbërjen, kompetencat, mënyrën e funksionimit dhe shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar Muzeve.

-Vendimin nr.24, datë 16.01.2019 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit.”.

-Vendimin nr.126, datë 13.03.2019 “Për Mbylljen e Përkohshme Të Veprimtarisë Së Ndërmarrjes Shtetërore"Qendra Ndërkombëtare e Kulturës "Arbnori”.

Ky vendim shfuqizon vendimin e Këshillit të Ministrave nr.286, datë 8.8.1991 “Për krijimin e Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës” dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr.384, datë

6.3.2009 “Për mbylljen e përkohshme të veprimtarisë së ndërmarrjes shtetërore Qendra Ndërkombëtare e Kulturës "Arbnori"”

-Vendimin nr.463 dt.03.07.2019 “Për përcaktimin e drejtimeve për miratimin e strategjive, programeve dhe planeve të veprimit për promovimin dhe krijimin e kushteve të nevojshme, për personat që u përkasin pakicave kombëtare për të përdorur dhe zhvilluar elementët themelore të identitetit të pakicave kombëtare, duke përfshirë dhe gjuhën e tyre.

Ky vendim përcakton miratimin e strategjive, programeve dhe planeve të veprimit për promovimin dhe krijimin e kushteve të nevojshme, për personat që u përkasin pakicave kombëtare për të përdorur dhe zhvilluar elementët themelore të identitetit të pakicave kombëtare, duke përfshirë dhe gjuhën e tyre

-Vendimin nr.462 dt.03.07.2019 “Për miratimin e masave dhe politikave të nevojshme për të siguruar pjesëmarrjen e personave që u përkasin pakicave kombëtare në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike në Republikën e Shqipërisë”.

Për miratimin e masave dhe politikave të nevojshme për të siguruar pjesëmarrjen e personave që u përkasin pakicave kombëtare në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike në Republikën e Shqipërisë”

-Vendimin nr. 432 dt.26.06.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore”.

Ky vendim sjell krijimin e IKRTK si institucion që do të zbatojë strategjitë dhe politikat e ministrisë në fushën e regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore.

-Vendimi nr.279 date 02.05.2019 “Për përbërjen, kompetencat, mënyrën e funksionimit dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore”

Ky vendim rregullon kuadrin ligjor të organit kolegjal Këshilli Kombëtar i Menaxhimit të Pasurive Kulturore ku përcaktohen rregullat mbi përbërjen, kompetencat, mënyrën e funksionimit dhe shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore.

-Vendimi nr.581 datë.28.08.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Tirane”.

-Vendimin nr.581 datë.28.08.2019 ”Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Vlorë”.

-Vendimin nr.581 datë.28.08.2019 ”Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë”.

-Vendimin nr.581 datë 28.08.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkoder”.

-Vendimin nr.581 datë.28.08.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Korçë”.

-Vendimin nr.581 datë.28.08.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Berat“.

-Vendimi nr.209 datë 10.04.2019 “Për miratimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale dhe përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të tij”. Ky vendim rregullon mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e KKTKJ si organ kolegjal vendimmarrës.

Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Jomateriale, duke qenë se në përberjen e tij do të jenë specialistët më të mirë të trashëgimisë jomateriale, me vendimarrjet e tij do të ndikojë direkt në mbrojtjen, promovimin, digjitalizimin, botimin e trashëgimisë kulturore jomateriale kombëtare.

-Vendimi nr.208 datë 10.04.2019 “Për përberjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”.

Ky vendim rregullon riorganizimin e ri të orgenit kolegjjial të KKTKM, në përshtatje me ligjin e ri, duke i dhënë kompetenca të reja sipas këtij organizimi, si dhe përcaktimi për shpërblimin e anëtarëve në përbërje të tyre.

-Vendimi nr.238, datë 17.04.2019 “Për emërimin në detyrë të kryetarit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë”.

-Vendimi nr.352, datë 04.04.2019 “Për krijimin e komisionit të vlerësimit dhe negocimit të kontratës me objekt "Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe i godinës së re të Teatrit Kombëtar" si dhe përcaktimin e kriterëve kualifikuese dhe vlerësuese dhe dokumentacionin e nevojshëm për të këtë procedurë”.

Ky vendim përcakton krijimin e komisionit të vlerësimit dhe negocimit të kontratës me objekt "Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe i godinës së re të Teatrit Kombëtar" si dhe përcaktimin e kriterëve kualifikuese dhe vlerësuese dhe dokumentacionin e nevojshëm për të këtë procedurë”.

-Vendimi nr.434 datë 26.06.2019 “Për funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me gjethe”.

-Vendimi nr.433 datë 26.06.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale”.

Ky vendim sjell krijimin e Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale me qëllim mbrojtjen, promovimin, digjitalizimin, botimin e trashëgimisë kulturore jomateriale Kombëtare.

-Vendimin nr.567 datë.31.07.2019 “Për emërimin në detyrë të drejtorit të Bibliotekës Kombëtare”.

-Vendimi nr.364, datë 29.05.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”.

-Vendimin nr.625 datë 04.09.2019 “Për miratimin e rregullave të administrimit të pasurive kulturore dhe funksionimin e subjekteve juridike me qëllim vlerësimin dhe rijetëzimin e pasurive kulturore”.

-Vendim nr.903 datë 24.12.2019 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Kulturës 2019-2025”

-Vendim nr.857,datë 24.12.2019 “Për Përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të konkurrimit, formën e kohëzgjatjen e kontratës dhe metodologjinë e caktimit të tarifave për dhënien në përdorim të Pasurive Kulturore Publike”.

Ky vendim përcakton procedurat dhe kriteret e konkurrimit, formën e kohëzgjatjen e kontratës dhe Metodologjinë e caktimit të tarifave për dhënien në përdorim të pasurive kulturore publike”.

-Vendim nr.828, date 18.12.2019 “Për Miratimin e Kushteve të Përgjithshme dhe të Posaçme të kontratës së Rijetëzimit”.

-Vendimi nr.127, date 13.03.2019 “Për miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet këshillit të ministrave të republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së republikës së maqedonisë së veriut, për themelimin e qendrave Kulturore dhe informative në Republikën e shqipërisë dhe qendrave kulturore dhe informative në Republikën e Maqedonisë Së Veriut “.

-Vendimi nr.84 dt. 20.02.2019 “Për dhënien me qira të reduktuar të Sallës së koncerteve të Pallatit të kongreseve, për TKOBAP “.

-Vendimi 2002/2019 “Për miratimin ne parim të programit ekzekutiv mbi bashkëpunimin kulturor ndërmjet qeverisë së Republikës Arabe të Egjiptit dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë”.

-Vendimi nr.379 dt.10.06.2019”Për lirimi nga detyra e drejtorit të Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatrit të Kukullave”.

-Vendimi nr.489 dt. 10.07.2019 “Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Bibliotekës Kombëtare.”

-Vendimi nr.559 dt. 31.07.2019 “ Për një ndryshim në vendimin nr.656 dt. 31.10.2018 të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave bordeve ose komisioneve të përhershëm të njësisve të qeverisjes qendrore”.

-Vendimi nr.647 date 02.10.2019 " Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Cirkut Kombëtar”.

-Vendimi nr.676 date.16.10.2019 miratuar ne Parim I Konventes se Keshillit te Europes per bashkeprodhimin Kinematografik (e rishikuar).

Ky vendim përcakton miratimin ne Parim I Konventes se Keshillit te Europes per bashkeprodhimin Kinematografik.

-Për miratimin e zonës arkeologjike “A” të qytetit të Elbasanit dhe të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e saj”.

-Për propozimin e projektligjit "Për Ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Për themelimin e Qendrave Kulturore dhe Informative në Republikën e Shqipërisë dhe Qendrave Kulturore dhe Informative Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

-Vendimi nr.702, datë 30.10.2019 “Për shfuqizimin e vendimit nr.564, datë 29.9.2018, të Këshillit të Ministrave “Për dhurimin UNESCO-s të ikonës “Ngjallja e Krishtit”, në kuadër të 60-vjetorit të anëtarëzimit në këtë organizatë”.

-Vendimi nr.858 dt.24.12.2019 “Per Emerimin e Drejtorit te Cirkut Kombetar”.

Kurse **produkti me kod 91201AB** “Staf i trajnuar” është kostuar duke ngarkuar shpenzimet operative të aparatit të MK, shpenzime të cilat justifikohen për ngritjen e kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese të stafit të MK, me qëllim përmbushjen me cilësi të detyrave funksionale për realizimin e objektivave të Sistemit të Kulturës.

Niveli i rishikuar i trajnimeve per vitin 2019 është rritur pasi janë përfshirë trajnimet e parashikuara për t'u zhvilluar nga ASPA. Gjatë periudhës janar-dhjetor janë realizuar trajnimet si më poshtë:

1. Monitorimi dhe Vlerësimi i Politikave
2. Planifikimi Buxhetor
3. Sistemi Informatik i Menaxhimit Financiar
4. Barazia gjinore dhe buxhetimi i përgjegjshëm gjinor
5. Partneriteti Publik Privat dhe Koncensionet
6. Arkiva elektronike
7. Statistika
8. Përafrimi i legjisllacionit
9. Negociimi dhe Vendimmarrja
10. Trajnim për gjuhën e huaj e-learning
11. Konsultimi Publik
12. Analiza gjinore dhe integrimi perspektives gjinore në Administratën Publike
13. E drejta e informimit dhe mbrojtja e të dhënave personale
14. Zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi i politikave gjithëpërfshirëse për personat me aftësi të kufizuara
15. Menaxhimi strategjik
16. Hartim dhe menaxhim projekti me financime
17. Menaxhimi strategjik
18. Hartimi dhe menaxhimi politikave publike
19. E Drejta e Informimit dhe Mbrojtja e të Dhënave Personale

20. HRMIS, Përdorimi i firmës elektronike dhe dergimin e “Urdhër Shpenzimeve” elektronike në sistemin e thesarit

21. HRMIS, modeli i përshkrimeve të punës dhe rezultateve në punë

22. Trajnim i detyrueshëm për nëpunësit civil në periudhë prove

23. Trajnim praktik në lidhje me platformën e bashkëpunimit për nëpunës civil me mbështetjen e Këshillit të Europës

Gjatë monitorimit 12-mujor Ministria e Kulturës ka evidentuar gjithashtu realizimin e qëllimeve, objektivave nëpërmjet treguesve të performancës të planifikuara nga ato të realizuara në fakt sikurse prezantohet në mënyrë të detajuar më poshtë:

Kodi i Programit	01110	Emertimi i programit:	Planifikim, Menaxhim, Administrim						
			**Treguesit e performancës/Produktet:						
		Kodi i Treguesit të Performancës/Produktit	Emertimi i Treguesit të Performancës***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhës	Niveli i planifikuar në vitin korent	Niveli i rishikuar në vitin korent	Niveli i planifikuar për periudhën progresive	Niveli faktik në fund të vitit korent	% e Realizimit të Treguesit të Performancës/Produktit
		Qëllimi i politikës							
Qëllimi 1	Mbështetje juridike, financiare dhe me burime njerëzore me qëllim zhvillimin e artit dhe kulturës përmes instrumentave ligjorë, institucional e financiarë.								
			Aplikime të fituara ndaj totalit të aplikimeve të kryera për thihje fondesh në programe komunitare	5	4	4	4	3	75%
			Masat ligjore për fushën e përgjegjësisë së MK të realizuara ndaj atyre të planifikuara në PKIE (Plani Komb I Integrimi Europian)	1	2	2	2	1	50%
			Marreveshje dy apo shumëpaleshe në fushën e Kulturës të nëshkruara ndaj totalit të planifikuar	5	4	4	4	3	75%
			Objekte të trashëgimisë arkitektonike dhe paisazhit të restauruara dhe mirëmbajtura kundrejt totalit.	130	140	140	140	140	100%
			Rritja e aksesit të publikut në Muze, Monumentet e kulturës dhe Parqe Arkeologjike në funksion të turizmit kulturor.(nr. Vizitore)	985,000	1,100,000	1,050,000	1,050,000	1,065,081	101%
		Objektivat e politikës:							
Objektivi	Krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm ligjor e institucional për zhvillimin e artit dhe kulturës								
			Ndryshim në rangim i MK ndaj ML(Ministrive të vogla), krahasuar me vitin 2017 referuar raportit të monitorimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm nga MFE	5	4	4	4	4	100%
			Auditime të kryera kundrejt totalit të synuar në planin strategjik 2019-2021	14	14	8	8	8	100%
			Rritja e aktiviteteve ndërgjegjësuese në nivel kombëtar për Brezat e rinj mbi të drejtat e autorit dhe të tjera të lidhura me to në krahasim me një vit më parë	20%	20%	20%	20%	20%	100%
			Rritje nr.shperblimeve për autoret-krijues në zbatim të ligjit nr.35/2016 për "Te drejtat e Autorit dhe të drejtat e lidhura me to"	50%	55%	55%	55%	55%	100%
			Raste Diskriminimi të konstatuara dhe të raportuara	-	-	-	-	-	#DIV/0!
			Numri i grave në pozicione drejtuese në raport me nr total te punonjesve bazuar në strukturen aktuale në fuqi	59%	60%	60%	60%	60%	100%

Nga sa më sipër rezulton se treguesit e performancës të listuar nën këtë program janë realizuar sipas pritshmërive dhe në disa raste janë tejkaluar dhe parashikimet.

-Përsa i takon treguesit të performancës **“Aplikime të fituara ndaj totalit të aplikimeve të kryera për thithje fondesh në programe komunitare”** ka rezultuar i suksesshëm duke u fituar 3 nga 4 aplikime.

Aplikimet e fituara në programet komunitare:

- 1-“Albas” Shtepi botuese (thirrja për perkthime letrare)
- 2-“Dituria” Shtepi botuese (thirrja për perkthime letrare)
- 3-Kishte një përfitues të tërthortë prej 25.000 euro-për shkak të pjesëmarrjes së Filmit Shqiptar në rast të "Transilvania International Film Festival 2019" Rumania.

Aplikimet të pa fituara në programet komunitare:

- 1-Për thirrjen për "Mbështetje për projektet e bashkëpunimit evropian", pati një aplikim nga Shqipëria, por ai nuk u zgjodh për financim.

-Për treguesin e performancës **“Masat ligjore për fushën e përgjegjësisë së MK të realizuara ndaj atyre të planifikuara në PKIE (Plani Komb i Integritimit Europian)”**, për 2019 janë dy masa ligjore të parashikuara në PKIE për t'u miratuar (Strategjia Kombëtare e Kulturës, si dhe projektligji për të përafuar një direktivë të BE-s në ligjin për të drejtën e autorit). Nga këto u realizua vetëm miratimi i Strategjisë Kombëtare të Kulturës me VKM nr.903 datë 24.12.2019 **“Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Kulturës 2019-2025”**.

-Treguesi i performancës **“Marrëveshje dy apo shumëpalëshe në fushën e Kulturës të nënshkruara ndaj totalit të planifikuar”**, është realizuar sikurse është parashikuar pasi gjatë këtij vitit janë nënshkruar 3 marrëveshje :

1-Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për themelimin e Qendrave Kulturore dhe Informative në Republikën e Shqipërisë dhe Qendrave Kulturore dhe Informative në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

2- Kalendar i Përbashkët Kulturor Vjetor midis Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës.

3-Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë mbi Bashkëpunimin Kulturor, firmosur në 2016 (por ka hyr ligjërisht në fuqi në 25 mars 2019).

-Përsa i përket **“Auditime të kryera kundrejt totalit të synuar në Planin Strategjik 2019-2021”**, gjatë 12-mujorit ishte parashikuar nga Sektori i Auditimit të Brendshëm (SAB) të realizoheshin 14 auditime, ndër të cilat janë zhvilluar 8 prej tyre kjo si rezultat i mungesës së stafit në këtë sektor.

Për treguesin e performancës **“Ndryshim në rankim i MK ndaj ML (Ministrive të vogla), krahasuar me vitin 2017 u planifikua që MK të ngrihej një vënd më lart se viti i kaluar**

konkretisht në vëndin e katërt. Krahas vlerësimit të performancës nëpërmjet treguesve të performancës për planifikimin, zbatimin dhe ekzekutimin e buxhetit Ministria e Financave dhe Ekonomisë për monitorimin e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Kulturës ka realizuar edhe monitorim të kryer direkt për vitin 2018 nga Drejtoria e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar, Kontrollin dhe Kontabilitetin e MFE-së, përmes të cilit MK është renditur në vëndin e katërt, midis 11 ministrive, me 49 pikë nga 68 pikë maksimale të mundshme.

Pra ky tregues është arritur sikurse ishte planifikuar madje vlen për tu theksuar se MK kishte planifikuar që të rankohej në vëndin e katërt nga vëndi i pestë që mbante në vitin 2017 referuar Ministrive të vogla por konkretisht MK është renditur e katra midis Ministrive të vogla e të mëdha.

2. Programi: “TRASHËGIMIA KULTURORE DHE MUZETË”

Programi Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë është një nga programet e Ministrisë së Kulturës i cili synon ruajtjen e integruar të tërësisë së vlerave të trashëgimisë kulturore, mbrojtjen dhe promovimin e saj si dëshmi e vlerave të trashëguara nga e kaluara, si shprehje e identitetit kombëtar dhe si pasuri e traditës kolektive.

Trashëgimia Kulturore përbëhet nga vlera materiale të luajtshme dhe të paluajtshme (dëshmi të arkitekturës, peizazhit, arkeologjisë) dhe vlera jo materiale që përbëjnë dijen dhe përvojën shpirtërore (ritet, zakonet, zejjet tradicionale, folklori dhe gjuha) të krijuar dhe transmetuar nga populli përgjatë shekujve.

Ky program zbatohet nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës në Ministrinë e Kulturës si dhe nëpërmjet 20 institucioneve në varësi të saj (si Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, Muzetë Kombëtarë, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale, Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, DRTK, Parqet Arkeologjike, etj.) në mbrojtjen, promovimin, edukimin dhe menaxhimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, zhvillimin e rrjetit të muzeve kombëtarë dhe lokalë, parqeve arkeologjike dhe lëvizjen e objekteve të trashëgimisë kulturore nëpërmjet përdorimit efikas dhe efektiv të burimeve financiare shtetërore dhe bashkëpunimeve me organet e qeverisjes vendore, partnerë ndërkombëtarë dhe PPP si dhe rritjen e aksesit të publikut në funksion të turizmit kulturor.

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë:

në 000/lekë

Gr.	Programi	Artikulli	Emertimi	Plani 12 mujorit 2019		Realizimi 12 mujorit 2019		Realizimi ne (%) ndaj Planit perfundimtar te vitit 2019
				Ne mije leke	Struktura ne %	Ne mije leke	Struktura ne %	
12	08220	600-601	Shpenzime Personeli	291,522	51.17%	286,967	54.88%	98.44%
12	08220	602-606	Shpenzime Korrente	243,235	42.69%	201,784	38.59%	82.96%
12	08220	230-231	Shpenzime Kapitale	35,000	6.14%	34,177	6.54%	97.65%
		Totali		569,757	100.00%	522,928	100.00%	91.78%

Sipas tabelës vëmë re se buxheti është realizuar në masën 91.78% ndaj planit të 12-mujorit 2019. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 51.17% të totalit dhe janë realizuar në 98.44% ndaj planit vjetor. Shpenzimet korrente zënë rreth 42.69% të totalit dhe janë realizuar në masën 82.96% ndaj vjetor. Shpenzimet kapitale zënë rreth 6.14% të totalit dhe janë realizuar në masën 97.65% ndaj planit vjetor.

Fondet buxhetore të këtij programi janë organizuar në pesë produkte, planifikimi dhe realizimi i të cilave, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme.

Kodi i Programit	08220	Emertimi i programit:	Trashëgimia Kulturore dhe Muzete						
			**Treguesit e performancës/Produktet:						
		Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli i planifikuar per periudhen progresive	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit
Qellimi i politikës									
<i>Qellimi 1</i>	Ruajtja, mbrojtja dhe promovimin e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale.								
			Objekte të trashëgimisë arkitektonike dhe peisazhit të restauruara dhe mirëmbajtura kundrejt totalit.	130	140	140	140	140	100%
			Rritja e aksesit te publikut në Muze, Monumentet e kulturës dhe Parqe Arkeologjike në funksion të turizmit kulturor.(nr. Vizitore)	985,000	1,100,000	1,050,000	1,050,000	1,065,081	101%
			Numri i nxënësve të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të përfshirë në aktivitete te fushes se trashëgimise kulturore	13,500	14,000	98,000	98,000	98,218	100.2%
			Numër në rritje i aktiviteteve, bartësve dhe ndjekësve të aktiviteteve, si rezultat i zbatimit të politikës së programit.	70	75	75	75	75	100%
Objektivat e politikës:									
<i>Objektivi 1</i>	Rehabilitimi i trashëgimisë arkitektonike dhe peisazhit përmes rritjes së numrit të monumenteve të rehabilituara								#DIV/0!
			Numri i objekteve të trashëgimisë arkitektonike dhe peisazhit të restauruara dhe mirëmbajtura kundrejt totalit;	130	140	140	140	140	100%
			Numër vizituesh në Monumentet e kulturës dhe Parqe Arkeologjike në funksion të turizmit kulturor;	680,000	750,000	750,000	750,000	747,255	99.6%
			Numër objektivash të regjistruara në databazën kombëtare të trashëgimisë kundrejt totalit;	30,424	30,800	98,000	98,000	98,218	100.2%
			Numri i nxënësve të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të përfshirë në aktivitete te fushes se trashëgimise kulturore	13,500	14,000	14,000	14,000	14,000	100%
<i>Objektivi 2</i>	Promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore								#DIV/0!
			Numri i vizitorëve në muzetë Kombëtarë;	206,838	300,000	300,000	300,000	317,826	106%
			Mbeshetja e aktiviteteve ne fushën e trashëgimisë kulturore	65	70	75	75	75	100%
			Raporti i grave artizane të mbështetura financiarisht ndaj totalit të përfutuesve	33%	35%	35%	30%	30%	100%

Sipas objektivave të politikës dhe produkteve përkatëse, ju informojmë si më poshtë;

- **Rehabilitimi i trashëgimisë arkitektonike dhe peizazhit përmes rritjes së numrit të monumenteve të rehabilituara.**

Restaurimi dhe mirëmbajtja e trashëgimisë arkitektonike dhe peizazhit:

OBJEKTE TE RESTAURUARA DHE TË MIRËMBAJTURA

Investime nga Buxheti Shtetit: U krye Restaurimi i objektit "Mësonjëtorja e Parë Shqipe, Korçë" - Fondi: 29, 647,238.4 lekë. Përmes këtij investimi u krye restaurimi i plotë i objektit, ruajtja e vlerave të monumentit, rritja e vlerave muzeale me synimin e rritjes së numrit të vizitorëve.

Mirëmbajtja e Monumenteve të Kulturës me fondin - Art 602, (mirëmbajtje e objekteve):

Në funksion të realizimit të objektivave dhe detyrave përgjatë vitit 2019, Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, si institucionet përgjegjëse në administrimin e vlerave të trashëgimisë kulturore në territoret nën juridiksionin e tyre, përmes zërit art. 602 të buxhetit të shtetit, me fondin **27,420,481 lekë**, kanë kryer punime **mirëmbajtje/restaurimi në 109 objekte** dhe **pastrime, sistemime në 83 objekte**. Punimet e realizuara në këto objekte konsistojnë kryesisht në nxjerrjen e objekteve nga gjendja e riskut apo dhe me qëllim mbrojtjen e tyre nga degradimi i mëtejshëm, kryesisht punime mirëmbajtje/restaurim çati, fasada, konsolidime muresh, konsolidime afreskesh, pastrime nga vegjetacioni si dhe në përgatitjen e objekteve të trashëgimisë kulturore për sezonin turistik.

Sipas Institucioneve mirëmbajtje/restaurim dhe pastrime të realizuara si më poshtë:

INSTITUCIONI	Nr. Monumente të mirëmbajtura (buxheti i shtetit Art 602)			
	MIRËMBAJTJE /RESTAURIM	PASTRIM	GJITHSEJ	Vlera e mirëmbajtjes (lekë)
DRTK BERAT	32	4	36	5,022,984
DRTK GJIROKASTËR	40	11	51	6,859,454
DRTK DURRËS	8	22	30	2,675,407
DRTK VLORË	8	24	32	3,923,223
DRTK KORÇË	8	20	28	2,573,359
DRTK SHKODËR	13	2	15	6,366,054
TOTAL	109	83	192	27,420,481

DRTK Berat – me fondin 5, 022, 984, ka kryer restaurime të pjesshme dhe mirëmbajtje në rreth **36 objekte** si: restaurimi i Urës së Kasabashit duke bërë të mundur nxjerrjen e objektit nga gjendja e riskut; Është kryer pastrimi nga vegjetacioni i lartë dhe i ulët në Qendrën Historike Berat, lagjja “Kala”. Nëpërmjet restaurimit të pjesshëm të çatave dhe fasadave në 16 banesa është arritur nxjerrja nga gjendja e emergjencës dhe mbrojtja nga dëmtimi i mëtejshëm, si dhe

restaurimi apo zëvendësimi i portave, në 6 banesa si dhe konsolidimi i mureve rrethuese të tyre, si dhe në mure rrethuese të cilat ndodhen në itinerare kryesorë të Qendrës Historike dhe restaurim mirëmbajtje kalldrëmi. Në kishat e lagjes kala, është kryer mirëmbajtje periodike si dhe restaurim i çative me qëllim mbrojtjen nga agjentët atmosferikë. Restaurimi i Afreskut të Kishës së Shën Triadhës dhe restaurimi i afreskut të Kishës së Shën Mërisë në fshatin Sinjë. Vendorsje e tabelave informuese, në Qendrën Historike, ka sjellë përmirësimin e sinjalistikës informuese dhe orientuese pranë monumenteve të kulturës gjithashtu u krye dhe zëvendësimi i tabelave të dëmtuara.

DRTK Durrës – me fondin 2,675,407 ka kryer pastrim nga vegjetacioni dhe mirëmbajtje në rreth 22 objekte si dhe restaurime dhe mirëmbajtje në 8 objekte: është realizuar Mbulesa e Mozaikut të Tiranës si dhe rrethimi me zinxhirë dhe rrethimi anësor me tenda të tejdukshme. Punime mirëmbajtjeje dhe pajantimi i disa mureve, që ndodhen pranë zonave ku kanë filluar gërmime arkeologjike tek Amfiteatri, Durrës. Pastrime nga vegjetacioni dhe mirëmbajtje periodike kryesisht në objektet e vizitueshëm të qytetit të Durrësit, Tiranës, Elbasanit, Muzeun Arkeologjik, Amfiteatër, Kalaja e Krujës, Kisha e Shën Ndoji-t në Kepin e Rodonit, Kalaja e Skënderbeut në Kepin e Rodonit, Kalaja Zgërdhesh si dhe në Termat Romake, Hamami, Forumi Bizantin, Muret Rrethuese të qytetit të Durrësit, Rotonda, Rrënojat e Ndërtesës me mozaik (GORA), Bazilikën e Shën Mëhillit Arapaj. Kalanë e Tiranës, Urën e Tabakëve Tiranë, Vendbanimi antik i Përsqopit, Pusi i Top Hanës, Kalaja e Elbasanit, Stacioni romak te Ad Quintum në Bradashesh, Bazilika paleokristiane Elbasan, Auzi dhe një pjese e kalldrëmit në qendër te qytetit te Elbasanit, Kala e Ndroqit, Kalaja e Krujës, Manastiri Ardenicës, etj.

DRTK Korçë – me fondin 3,923,223 lekë, ka kryer pastrime dhe mirëmbajtje në rreth 20 objekte, dhe restaurime në 8 objekte, si: Restaurimi i tirandave në Kishën e Shën Mërisë, Voskopoje. Konsolidime - Kisha e Shën Kollit, Vodicë. Restaurim i çatisë - Kisha e Shën Jovanit, Boboshtice. Konsolidime, pastrime - Kisha e Shën Mërisë në Nicë, Pogradec. 6 Kishat e Voskopojës dhe 4 Kishat e Vithkuqit, janë në monitorim periodik dhe është kryer pastrimi i territorit përreth tyre nga barërat, pastrime të dëborës, kontroll i çative, konsolidimi i pikturave murale si dhe përgatitja për sezonin turistik. Në Bazilikën e Linit, pastrimi i territorit nga barërat dhe pastrimi i mozaikëve, hapja e mozaikëve gjatë sezonit turistik dhe mbyllja e tyre. Në Tumat e Kamenicës, pastrimi i territorit dhe restaurimi i gardheve rrethuese prej druri dhe punime mirëmbajtje me rastin e zhvillimit te aktiviteteve, etj.

DRTK Gjirokastrë – me fondin 6,859,454 lekë, ka kryer restaurime të pjesshme dhe mirëmbajtje në 40 objekte si dhe pastrime sistemime në 11 objekte. Është kryer restaurim total i shtëpisë së Andon Zako Çajupit në Sheper të Zagorisë. Restaurim total në Kroin e Selckës, ndërhyrje restauruese në Kalanë e Gjirokastrës, si restaurim muri, mirëmbajtje dhe pastrime në ambientet e kalasë dhe skenës, ndërhyrje restauruese në banjat në Kala, etj. Në 24 banesa,

kryesisht për nxjerrjen e objekteve nga gjendja e riskut apo dhe me qëllim mbrojtjen e objekteve nga degradimi i mëtejshëm, janë kryer restaurime në çati, fasada, dritare, si dhe restaurim i portave. Janë kryer pastrime sistemime dhe mirëmbajtje tek kalaja e Libohovës, Kalaja e Nivicës, Shtëpia e Myfit Kaçubajt brenda kalasë së Nivicës, Mullirin e Nivicës, Ura e Muço Hysës, Kalaja e Leklit në fshatin Lekël, Kisha e Shën Thanasit në fshatin Lekël, Kisha e Shën Mëhillit, Kalaja e Zharrës, Turan, Kalaja e Horës, Dukaj, Adrianopol. Në Parkun Arkeologjik Antigone u riparuan tabelat ekzistuese informuese si dhe u kryen restaurime të ndryshme.

DRTK Vlorë – me fondin 2,573,359 lekë, janë kryer pastrime në rreth **28 objekte**, si dhe restaurime me projekte të miratuar në KKR me firma të specializuara **në 8 objekte**: U kryen restaurime tek Kisha e Armenit, Restaurim, mirëmbajtje, Kisha e Shën Stefanit, Dhërmi, Pastrim nga vegetacioni, riparim i biletarisë dhe i sheshpushimeve në Parkun Arkeologjik Finiq. Restaurim, mirëmbajtje, Kisha e Marmiroit. Pastrim vegetacioni, ndërtim biletarie, Kalaja e Himarës. Pastrim nga vegetacioni, anastilozë, punime gjermim shpëtimi në nekropol të P.A. Amantia, si dhe restaurim, mirëmbajtje, Muret rrethuese të Aulonës, Ura e Gjipesë, etj.

Pastrime dhe mirëmbajtje periodike kryesisht në objektet e vizitueshëm si në: Kisha e Shën Kollit Mesopotam, Manastiri i 40 Shenjtorëve, Bazilika – Sinagogë Sarandë, Shpella me piktura, Kostar, Xhamia e Muradies, Bazilika e Peshkëpisë, Manastiri i Zvërnecit, Xhamia e Gjin Aleksit Rusan; Kalaja e Kaninës, Kalaja e Borshit, Kalaja e Porto Palermos, Kalaja e Himarës, Porta hyrëse dhe muri rrethues i kalasë së Onhezmit, Mozaiku te Posta e vjetër, Muzeu Kombëtar i Pavarësisë, Muzeu Etnografik, Muret Antike Çukë; P.A. Orik, P.A. Amantia, Parku Arkeologjik, Finiq; Ura e Brataj, Ura e Frëngut, Ura e Slapit Ura e Gjipesë; Banesa e Kujtim Hamzajt, Banesa e Shefikat Beges, Kullat e Dervish Aliut.

DRTK Shkodër – me fondin 6,365,998 lekë, kryesisht me firma të specializuara ka kryer restaurim konservim dhe mirëmbajtje në **13 objekte**, kështu: Në Kalanë e Shkodrës, është kryer ri ngritja e murit lindor dhe restaurimi i murit ndarës midis oborrit të parë e të dytë në anën lindore të Kalasë, si dhe mirëmbajtje, konservime. Mirëmbajtje, konservim, restaurim i shpatullave të Porta antike në qytetin e poshtëm të Lisit, Lezhë. Restaurimi dhe mirëmbajtje Banesa Ismet Halili, Shkodër. Mirëmbajtje muret Antike Lezhe, Ri ngritje i blloqeve antik, Konsolidim dhe restaurim i mureve antike të Lisusit. Restaurim dhe konsolidim i mureve si dhe fugatim i tyre në objektin Castrumi i Vigut, Vig-Mnel, Bashkia Vau Dejës. Restaurim mur guri, fugatim i murit dhe ringritjen e një segmenti të dëmtuar në Urën e Navredës, VukPalaj, Bashkia Malesi e Madhe. Restaurim mur guri dhe fugatim muri tek Ujësjellësi i Domgjonit, Domgjon, Bashkia Mirdite. Pajantim i kullës Banesa Adem Demaj. Restaurim dhe konsolidim i strukturës, Ura e Tamares. Restaurim çati, restaurim tavani, etj., të objektit Banesa Rustem Kryekurti. Restaurim i strukturës, fugatim përgjatë gjatësisë së saj dhe restaurim kalldrëmi, Ura e Shkinës. Restaurimi i Banesës Nazif Muka, në bashkëpunim me Shoqëria SNG Energy. Rinovim panelesh

informuese, si dhe me punëtorët e mirëmbajtjes ka kryer punime pastrimi në kalanë e Shkodrës, kalanë e Lezhës dhe tek Ura e Mesit.

Gjithashtu dhe Parqet Arkeologjike kryejnë punime mirëmbajtje periodike edhe në funksion të Parkut si Atraksion i rëndësishëm turistik, kështu:

Zyra e Administrimit dhe Koordinimit Butrint:

Gjatë vitit 2019 u parashikuan investime kapitale, si ndërtimi i ujësjellësit në park, blerja e pajisjeve për zyra, pajisje kompjuteri dhe pastrim nga vegjetacioni. Realizimi i tyre është 63%. Kjo shpjegohet me faktin se realizimi i pagesës për Ndërtimin e Ujësjellësit nuk është kryer në masën 100% për shkak të vendosjes së prioritetit të pagesave nga ana e Ministrisë së Financave për shkak të emergjencave. Gjithashtu investimi i planifikuar për “Pastrimin në Muret e Kalivosë” do të bëhet gjatë vitit 2020. Gjithashtu janë kryer mirëmbajtje të objekteve specifike (monumente, pastrim vegjetacioni, etj.), mirëmbajtjen e shtigjeve (pastrimi i vegjetacionit të itinerareve turistikë dhe shtigjeve mjedisore, pastrimi i pyllit, etj.).

Zyra e Administrim dhe Koordinimit të parkut Arkeologjik Apoloni,

Gjatë vitit 2019 vazhdoi rregullisht puna për pastrim dhe monitorim në monumentet e gërmuara, ambientet e manastirit mesjetar dhe përreth tij. Karakteri i punimeve është i lidhur me mirëmbajtjen e monumenteve dhe ambienteve rreth tyre, si dhe pastrimi dhe evakuimi i mbeturinave jashtë parkut arkeologjik.

Janë kryer Restaurime/Mirëmbajtje: Muri i Temenosit, Muri verilindor i Manastirit të Shën Mërisë, Niket e murit të tarracimit, si dhe janë kryer dhe mirëmbajtje të gjithë monumenteve (duke realizuar konsolidimet e tyre gjatë sezonit por edhe në fund të tij), si:

Mirëmbajtja e mozaikëve të sitit, hapja e tyre dhe ndryshimet e materialeve të mbrojtjes. Mirëmbajtja e sinjalistikës së monumenteve dhe parkut, po ashtu dhe tabelat shpjeguese Mirëmbajtja e muzeut, zyrave dhe infrastrukturës ndihmëse për turistët (tualetet, tabela informuese) si edhe pjesës muzeale të Manastirit.

Mirëmbajtja e tualeteve në infrastrukturën e tyre dhe ndërhyrja në disa pjesë të sistemit elektrik të Manastirit (Kishës dhe Zyrave të parkut), si dhe Mbajtja pastër e sitit nga mbetjet e krijuara nga vizitorët.

Zyra e Administrim dhe Koordinimit të parkut Arkeologjik Bylis, ka kryer pastrime periodike nga vegjetacioni në monumentet e parkut, me objektiv mirëmbajtjen e monumenteve dhe ambienteve rreth tyre.

Gjatë vitit 2019, punonjësit e IMK, sot **Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore** kanë hartuar dhe miratuar në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve 51 projekte restaurimi si dhe punonjësit e këtij institucioni kanë ndjekur procedurat e supervizimit dhe kolaudimit në 28 objekte. Njëkohësisht janë realizuar ndërhyrje konservuese – restauruese, si:

- Përfundimi i ndërhyrjes konservuese - restauruese në laboratorin e IMK në ikonën "Mbledhja e krye engjëjve" nga fondi i Muzeut Historik Kombëtar;
- Ndërhyrje restauruese në laboratorin e IMK në ikonën "Deisis" pjesë e Pavionit të Artit Mesjetar në Muzeun Historik Kombëtar;
- Ndërhyrje konservuese - restauruese në laboratorin e IMK në ikonën "Triptik" ardhur nga Parku Kombëtar i Apolonisë;
- Hapja e mozaikut e banesës me peristil Sektori G në Apoloni (për ekspozim);
- Hapja e fragmentit me mozaik në Bazilikën e Madhe në Butrint (për ekspozim);
- Monitorim të punimeve në mbulesën e mozaikut të Tiranës;
- Hapja e mozaikëve në qytetin e Durrësit;
- Ndërhyrje konservuese - restauruese në Laboratorin e Restaurimit të Veprave të Artit për trajtimin e fragmenteve të hequra të pikturës murale nga kisha e Shën Todrit Kadipashaj;
- Ndërhyrje konservuese - restauruese në ambientet e MHK në objektin prej guri (piktogram) i marrë nga fshati Xhuxhë, Mirditë dhe përgatitja e tij për ekspozim.

Emergjenca në vijim të tërmetit nëntor 2019:

Në vijim të tërmetit 6.4 ballë që goditi Shqipërinë, mëngjesin e 26 nëntorit 2019 dhe gjendjes emergjente të shkaktuar si pasojë e shkatërrimeve që pasuan lëkundjet sizmike, nën koordinimin e Ministrisë së Kulturës (Komisioni i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile), IKTK dhe DRTK –të kanë organizuar punën për inspektimet e shpejta vizuale për konstatimin e dëmeve në objekte dhe zona të trashëgimisë kulturore. Në kuadër të këtij angazhimi, IKTK ka hartuar dhe përditësuar Databazën e Inspektimeve, si dhe është përcjellë pranë Ministrisë së Kulturës dhe UNESCO-s raporte mbi vlerësimin e dëmit në objekte dhe zona të trashëgimisë kulturore në të gjithë territorin e Shqipërisë. Në periudhën 26.11.2019-13.12.2019 janë inspektuar nga IKTK-ja, DRTK-të Durrës, Shkodër, Berat, Korçë, gjithsej 215 monumente kulture/site/institucione varësie të MK-së. Ministria e Kulturës nëpërmjet IKTK përfaqësohet gjithashtu në Komitetin ndërministror të hartimit të dokumentit të PDNA-së (Post Disaster Needs Assessment) të koordinuar nga Ministria e Bujqësisë.

Ministria e Kulturës ka përcjellë informacionin e nevojshëm mbi dëmet e tërmetit në Kryeministri, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe pranë Ministrisë të Shtetit për Rindërtimin.

➤ **Përmirësimi i standardeve dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara në muzetë dhe objektet e vizitueshëm të Trashëgimisë Kulturore / Parqeve arkeologjik.**

Muze të mirëmbajtur dhe të vizitueshëm nga publiku

Aktiviteti kryesor i Muzeve Kombëtarë është promovimi, ruajtja, konservimi, restaurimi i objekteve dhe fondeve muzeore si dhe implementimi i programit “*Edukimi përmes Kulturës*” dhe aktivitetet në funksion të saj. Një komponent i rëndësishëm është dhe pasurimi me fonde dhe përmirësimi i prezantimit përmes ekspozitave dhe përshkrimeve të objekteve në nivele bashkëkohore. Njëkohësisht pjesë e veprimtarisë së këtyre institucioneve janë edhe ekspozitat e ndryshme të cilat realizohen nga vetë institucionet përmes prezantimit të objekteve pjesë e fondeve në ruajtje të tyre, apo dhe realizimet e veprimtarive dytësore si filmimet, fotografimet e objekteve muzeore nga subjekte të treta, si dhe riprodhimi i imazhit të objekteve të trashëgimisë kulturore, me qëllim ekspozimin e tyre, në kuadër të aktivitetet të ndryshme.

Muzeu Kombëtar të Fotografisë “Marubi”,

Gjatë vitit 2019, përveç performancës lidhur me vizitueshmërisë ka realizuar dhe **61** aktivitete të tjera promovuese me qëllim publikimin e objekteve të trashëgimisë kulturore si edhe në kuadër të Programit Edukimit mbi dhe përmes Kulturës, aktivitete me karakter edukues në bashkëpunim me shkollat e qytetit. Njëkohësisht Vizitueshmëria në këtë muze ka qenë në nivelet më të larta si rezultat i performancës së lartë të këtij institucioni.

Janë organizuar aktivitete në fokus temat “Vizato portretin”, “Bëj maskën tënde”, “Çfarë fshihet pas një shkrepje”; “Mos u nxeh Shkodra”; “Fotografia si ritual”, “Phinole Camera” “Kartolina ime”, etj.

Njëkohësisht gjatë viti 2019 janë realizuar dhe 3 ekspozita të suksesshme “Dinastia Marubi” me temë: “Rituali Fotografik”, “Fotografë të Juglindjes shqiptare”, “Beyond the image”.

Muzeu Historik Kombëtar,

Gjatë vitit 2019, ka realizuar **168** veprimtari me karakter promovuese, edukues në të gjithë hapësirat muzeore dhe ato mbështetëse nga vetë institucioni ose përmes bashkëpunimit me aktorë të tjerë në funksion të realizimit të misionit të tij. Pjesë e veprimtarisë së këtij muzeu ka qenë dhe restaurimi i një sërë objektivash të trashëgimisë kulturore pjesë e fondit të muzeut, trajtim dhe mirëmbajtje objektivash në bashkëpunim me Institutin e Monumente të Kulturës, aktivitete në

nderim dhe përkujtim të figurave patriotike shqiptare si dhe në kuadër të programit “Edukimi mbi dhe përmes kulturës” u zhvilluan projektet edukative “Arkeologu i vogël”, “Një pasdite në muze”, “Vizatoj historinë”, “Muzeu im” “Një orë leksioni në muze”, “Një ditë me kuratorin”, “Muzetë rrëfejnë”, “Holokausti, eklips i arsyes njerëzore”, Aktivitet të vazhdueshme si rezultat i bashkëpunimit të MHK me institucioneve të tjera në fokus promovimin e vlerave të historisë, kulturës dhe trashëgimisë sonë kombëtare; ekspozita “Hello my name is Tirana”, hapur në Muzeun kombëtar të Bullgarisë dhe në ambientet e Universitetit të Sofjes “Kliment Ohridski”, ekspozita “Rrugëtim i Ismail Qemalit”, hapur në Muzeun e Kosovës, në kuadër të kalendarit të përbashkët të aktiviteteve Shqipëri – Kosovë”.

Njëkohësisht janë hapur një sërë ekspozitash në bashkëpunim me institucione dhe artistë të ndryshëm: Ekspozita fotografike “Kthim në kohë, Shqipëria e vitete’90”, “Rrugëtimi”, Ekspozita e artistit rumun “Mbreti I Diktaturës”, “Piktorët ulqinakë në Tiranë”, “Ndërmjet artistit dhe kritikut” “Feja në shoqëri- modeli shqiptar”, “Trashëgimia shpirtërore përmes instrumenteve muzikor”, ekspozitat “Leonardo- Opera Omnia”; Ekspozita “Nënë Tereza 3–vjetori i Shenjtërimin. ”Universi” “Luftii dhe Vuajtja”, “Mozaiku i Jetës”, The luxury of Italian style, home, hotek, living space”, “Edicioni i tretë etj.

Në 18 Maj, Ditën Ndërkombëtare të Muzeve: u realizuan aktivitetet “Muzeu lëvizës” “Trashëgimia Kulturore”.

Në kuadër të Ditës Botërore të Diversitetit kulturor u zhvilluan aktivitetet: “Diversiteti si vlerë evropiane”; Tryezë e rumbullakët me temë: “Trashëgimia Kulturore Jomateriale dhe Diversitetit; Festalet Folklorike mes ruajtjes së kujtesës dhe pasqyrimin të praktikave kulturore të gjalla”, etj.

Në kuadër të Fushatës “Lëvizja Kombëtare për Lexim”, në Muzeun Historik Kombëtar janë organizuar takime leximi me nxënësit e shkollave 9-vjeçare me pjesëmarrjen e njerëzve të njohur në fushën e kulturës.(6 aktivitete)

Një sërë aktiviteteve në përkujtim dhe nderim të figurave dhe ngjarjeve historike: “Shkolla e parë shqipe Mësonjëtorja” “11vjetori I Pavarësisë së Kosovës”; “77 vjetori i vdekjes së Faik Konicës”; “jeta dhe vepra e Ismail Qemalit”; Forumi II “Kosova e çliruar 20 vite më pas”, etj.

Muzeu Historik Kombëtar gjatë vitit 2019 ka realizuar 7 botime “Thesare të Muzeut Historik Kombëtar” shqip-anglisht; “Austro-Hungaria dhe Shqipëria 1916-1918” (shqip-gjermanisht); Revista “Studime Muzeologjike nr.9”; Fletëpalosje promocionale për Muzeun Historik Kombëtar”; Fletë-palosje për ekspozitën “Rrugëtim Ismail Qemali ndër vite” për ekspozitën “Hello my name is Tirana” “Shqipëria nën fokusin e Austro – Hungarezëve 1916-1918”.

Një nga veprimtaritë e Muzeut Historik Kombëtar ka qenë promovimi librave dhe katalogëve.: “Monografia “Austri Hungaria dhe Shqipëria 1960-1918, “Lindja e një demokracie: Hashim Thaçi rruga drejt pavarësisë së Kosovës”, libri “Turist në Utopi-udhëtime në ideologji dhe në peizazhin shqiptar”; “Për Flamujt e muzeut”, katalogu “Thesare të Muzeut Historik Kombëtar”, libri “Pena e Lirisë”, “Dokumente diplomatike italiane..” etj.

Shënon një rritje të vazhdueshme të vizitueshmërisë gjatë periudhës së sezonit turistik veror 2019

Muzeut Kombëtar i Artit Mesjetar, Arsimit dhe Arkeologjik, Korçë.

Veprimtaria e këtij institucioni është përqendruar në pritjen e vizitorëve dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë që administrohen nga këta muze. Gjithashtu dhe në aktivitete promovuese dhe edukuese në kuadër dhe programit Edukimi mbi dhe përmes Kulturës. Në bashkëpunim me shkollat 9 vjeçare, të mesme dhe universitetin, janë zhvilluar **34** aktivitete në kuadër të nismës “Edukimi përmes Kulturës” “Vizitë në muze”, “Ç’është Trashëgimia Kulturore”, ”Ikonografët Shqiptarë”, “Pasuritë arkeologjike të zonës së Devollit”, “Njohje me veprat ikonografike të Onufrit”, “Vizitë në muze”, “Epoka e hekurit” “Leximi i përrallave për krishtlindje”; ekspozitë me dëftesa dhe diploma të shkollave të Korçës në fillimet e Arsimit në Shqipëri; ekspozitë me fakte historike rastin e 105 vjetorit të formimit të kabinetit të Princ Vedit në Shqipëri; ekspozitë Art-Argjend me punime të metalit e argjendit, pjesë e fondit MKAM, Korçë”

Muzeu i Arsimit, Korçë, për shkak të tërmeteve të rëna në qarkun e Korçës në fillim të muajit Qershor 2019 ka qëndruar i mbyllur me qëllim evitimin e çdo dëmtimi të krijuar. Gjatë vitit 2019 u krye restaurimi i plotë i godinës dhe është në proces realizimi i një platforme të re muzeore. Njëkohësisht dhe **Muzeu Arkeologjik** pjesë e strukturës së kësaj drejtorie ka vijuar aktivitetin e tij muzeore por në kushte duke reduktuar një pjesë të mirë të aktiviteteve dhe monitorim të numrit të vizitorëve për shkak të disa dëmtimeve të krijuara nga tërmeti i qershorit të këtij viti në qarkun e Korçës.

Qendra Kombëtare e Muzeumeve Berat,

Gjatë vitit 2019, për mbarëvajtjen e procesit të punës dhe mirëmbajtjen e objekteve janë kryer dhe realizuar **37** veprimtari me karakter edukues dhe promovuese dhe njëkohësisht dhe mirëmbajtje të objekteve muzeore. Dezinfektimi i ambienteve dhe objekteve. Konsolidimi dhe konservimi i disa objekteve për mirëmbajtjen e tyre. Përgatitja e kartelave të reja për disa nga objektet e shtuara në koleksionin e Muzeut Etnografik gjatë vitit 2018, të dhuruara nga DRTK Berat. Përgatitje dhe përditësim informacioni, fletëpalosje në kuadër të fillimit të sezonit turistik. Janë realizuar 27 aktivitete të QKM-Berat me shkollat 9-vjeçare të qytetit në kuadër të programit “Edukimi përmes Kulturës”.

Realizimi projektit “Konservuesit e Vegjël”, i cili synon që nxënësit të njihen me rolin dhe funksionin që kanë punonjësit në muze; vijimi i projektit “Muzeu në Puzzle”, ku nëpërmjet puzzle nxënësit zbulojnë misterin e muzeut duke vënë në dispozicion njohuritë e marra nga fotot shoqëruese të puzzle; vijimi i projektit “Të njohim trashëgiminë kulturore të qytetit tonë. ”Loja mos u nxe” me nxënësit e shkollave 9-vjeçare të qytetit; projektit “Muzeu Tradita dhe Tregime Imagjinare”, synimi i këtij projekti është të siguroj lidhje, të kuptojnë të kaluarën nëpërmjet

Artit. Projekti :Atelier në Trashëgiminë Kulturore; Projekti, “Muzeu Tradita dhe Tregime Imagjinare”, “Artizanati dhe Brezi i ri”; leksioni “Muzeu dhe koleksioni i tij” Projekti: Të njohim trashëgiminë kulturore të qytetit tonë”; ekspozita.

Në ditën Ndërkombëtare të Muzeve, 18 Maj, është hapur ekspozita “Thesare të fjetura”, dhe “Berati i vjetër”, ndërsa në 29 shtator ekspozita me veshje tradicionale të trevave të ndryshme shqiptare “Vishu me traditën merr një kujtim”.

Një ndër aktivitetet e rëndësishme të ndodhura në këtë muze është lancimi dhe implementimi i projektit të audio guidave i realizuar falë donacionit të CBS ku përmes audioguidës vizitori mund të prek dhe të ndjek në 6 gjuhë të huaja historinë e ikonografisë shqiptare të performuar në këtë muze. Falë këtij projekti është rritur në mënyrë të ndjeshme numri i vizitorëve të cilët duan të ndjekin historinë e këtij muzeu përmes audio guidës.

Muzetë Kombëtarë “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” dhe Etnografik, Krujë.

Gjatë vitit 2019, fokusi kryesor i punës në të dy muzetë ka qenë ruajtja, mbrojtja dhe promovimi i vlerave muzeore, si dhe mirëmbajtja e tyre. Gjatë kësaj periudhe ndër prioritet kryesorë ka qenë Vizitueshmëria si dhe aktivitetet e Programit Edukimi mbi dhe përmes Kulturës. Në bashkëpunim dhe shkollat 9-vjecare të qytetit të Krujës dhe qyteteve të tjera, janë zhvilluar **17** aktivitetet në kuadër të Programit “Edukimi përmes Kulturës”, aktivitetet në përkujtim të figurës së Skënderbeut, si dhe ngjarjeve historike në vendin tonë, si: “551 vjetori i vdekjes së Gjergj Kastriot Skënderbeut”, “575 vjetori i Besëlidhjes së Lezhës”, Mësojmë dhe argëtohem në muze”, “Arkeologu i vogël”, “Muzeu lëvizës”.

Në bashkëpunim me NATGA Training Center është realizuar aktiviteti “Udhërrëfyes në Muzetë e Krujës”, si dhe aktivitetet sensibilizues në Ditën Botërore të Turizmit dhe Ditën Kombëtare të Trashëgimisë kulturore.

Në bashkëpunim me Bashkinë Krujë janë zhvilluar aktivitetet dhe panairë për promovimin e trashëgimisë dhe turizmit kulturor “Food Fair at the Castle”, “Rock the castle”, si dhe disa aktivitetet kulturore mbështetur nga Ministria e Kulturës “AME CUARTET CLARINET”

Muzeu Kombëtar Pavarësia Vlorë

Gjatë vitit 2019 kryer një sërë aktivitetesh me karakter promovuese dhe edukues, (**9 aktivitetet**) si dhe aktivitetet në përkujtim të figurave të shquara dhe ngjarjeve të rëndësishme historike-kulturore, ekspozita të artistëve të rinj, promovime librash, me fokus kryesor promovimin e trashëgimisë sonë kulturore dhe vlerave muzeale; 100 vjetori i vdekjes së Ismail Qemali; aktivitet kulturor “Klasikët përballë Jazz”, “Telegramet e qeverisë së Vlorës”; ekspozitë me objekte të rralla nga jeta e Ismail Qemalit, me rastin e 18 Majit, Ditës Ndërkombëtare të Muzeve. Për arsye të vendodhjes së tij në një prej qyteteve bregdetare i cili ka një frekuentim të madh të vizitorëve jo vetëm vendas por dhe të huaj gjatë sezonit turistik veror është shënuar një rritje e numrit të vizitorëve. .

Muzeut Kombëtar “Gjethi”.

Gjatë vitit 2019, veprimtaria e këtij institucioni është fokusuar në objektivat kryesore për promovimin e vlerave historiko-kulturore si dhe pritjen e vizitorëve, me qëllim njohjen dhe ndërgjegjësimin e brezit të ri mbi të kaluarën komuniste. Ndër veprimtaritë kryesore është projekti “Kujtojmë për të mos harruar”, dhe “Mbresa”, në bashkëpunim me shkollat e mesme të qytetit, ku përgjatë viti 2019 janë realizuar 42 aktivitete.

Ekspozitë fotografike "Qëndresa" Promovimi i revistës shkencore të MKGJ "Dritëhije", ekspozita “Përkujtim përmes memories dhe dialogut mbi të kaluarën”, ekspozita “Rrugëtim i Shqipërisë në komunizëm”.

Lidhja e marrëveshjes së bashkëpunimit me Qendrën Sociale Multidisiplinare dhe Muzeut Kombëtar “Gjethi”, pjesë e programit të shkëmbimit Shqipëri-Kosovë "Si n ‘shtëpinë tënde”.

Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me Gjethë" përgjatë vitit 2019 aplikoi për të marrë pjesë në garën për të fituar **Çmimin “Muzeu Evropian i Vitit” për 2020**, i cili arriti të fitojë çmimin prestigjioz: **Muzeu i Këshillit të Evropës 2020**.

Zyra e Administrim dhe Koordinimit të parkut Arkeologjik Apoloni

Gjatë vitit 2019 ka realizuar veprimtarinë e tij në fokus të promovimit dhe ruajtjes së vlerave të trashëgimisë sonë arkeologjike. Është realizuar zbulimi i mozaikut në pjesën jugore të korridorit të banesës me impluve. Kjo veprimtari është mbështetur në aktivitete mbi programin “Edukimi përmes kulturës” apo edhe aktiviteteve të tjera kulturore apo trajnimeve. Në kuadër të “programit edukimi përmes kulturës” janë realizuar përgjatë 2019, rreth 15 aktivitete; Janë realizuar 3 projekte restaurimi: Muri i Temonosit; Muri Verilindor i Manastirit të Shën Mërisë; Niket e murit të tarracimit; Janë realizuar në zërin mirëmbajtje rreth 6 procese në monumente; Monitorim të 1 gërmimi arkeologjik që realizohet nga ekipi shqiptaro-francez: por gërmohet porta verilindore e cila lidh Apoloninë me rrugën Egnatia e cila më pas do ti nënshtrohet procesit të restaurimit;

Në kuadër të bashkëpunimit me ekipin shqiptaro-gjerman të i cilët kanë në fokus studimin e materialeve arkeologjike, pjesë e fondit të Muzeut Arkeologjik dhe të IA në vijimësi do të publikohet katalogu me foto të gjithë objekteve të gurit;

Bashkëpunim me fondacionin Flamina në Ravena; Universitetin e Bilonjës; IMK dhe IA u realizuar ndërhyrja restauruese e mozaikut (tek dhoma e aktorit) të hequr të Vilës së Athinasë; Menaxhimi riskut dhe mirëmbajtja shpesh herë kanë patur edhe pika të paparashikuara të cilat kanë dalë në pah si rezultat i emergjencave por edhe dëmtimeve njerëzore; natyrore dhe teknike.

Zyra e Administrim Koordinimit Butrint

Gjatë vitit 2019 janë realizuar disa aktivitete në funksion të promovimit, ruajtjes dhe administrimit të sitit dhe në funksion të kalendarit të festave zyrtare. Aktivitetet kryesore janë


fokusuar në bashkëpunimin me shkollat në kuadër të ditëve ndërkombëtare të trashëgimisë me fokus në promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të sitit, në kuadër të programit “Edukimi përmes Trashëgimisë” dhe projekteve të bashkëpunimit.

VIZITUESHMËRIA NË INSTITUCIONE DHE QENDRA TË TRASHËGIMISË KULTURORE GJATË MUAJVE JANAR – DHJETOR 2019

Institucionet dhe qendrat e trashëgimisë kulturore gjatë periudhës janar - dhjetor 2019 janë vizituar nga **1,065,007** vizitorë vendas dhe të huaj, nga të cilët **317,826 në** Muzetë Kombëtarë, **424,786** në parqet arkeologjike dhe **322,395** në monumente të kulturës.

I. Vizitueshmëria gjatë muajve janar - dhjetor në vitet 2015 -2019

Muajt janar-dhjetor 2019 shënojnë 66,566 vizitorë në total më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2018, 395,897 vizitorë më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2017, 515,310 vizitorë më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2016 dhe 601,325 vizitorë më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2015 (grafiku më poshtë).



Analiza krahasuese e të dhënave statistikore për muajt janar-dhjetor në vitet 2015-2019 dëshmon se trendi i vizitueshmërisë ka shënuar rritje në krahasim me të njëjtën periudhë në vitet 2015, 2016, 2017 dhe 2018.

Trendi i vizitueshmërisë (vizitorë në total) gjatë muajve janar-dhjetor në vitet 2015-2019 (në %):

Në krahasim me periudhën janar-dhjetor 2018, vizitueshmëria në të njëjtën periudhë 2019 ka shënuar **rritje prej 7%.**


Në krahasim me periudhën janar-dhjetor 2017, vizitueshmëria në të njëjtën periudhë 2019 ka shënuar **rritje prej 59%.**

Në krahasim me periudhën janar-dhjetor 2016, vizitueshmëria në të njëjtën periudhë 2019 ka shënuar **rritje prej 94%.**

Në krahasim me periudhën janar-dhjetor 2015 vizitueshmëria në të njëjtën periudhë 2019 ka shënuar **rritje prej 130%.**

II. Të ardhurat e gjeneruara nga institucionet gjatë muajve janar-dhjetor në vitet 2015 -2019

Të ardhurat e gjeneruara nga vizitueshmëria gjatë muajve janar - dhjetor 2019 kanë shënuar rritje në krahasim me të njëjtën periudhë në vitet 2015-2018 (grafiku më poshtë).



Analiza krahasuese e të ardhurave nga vizitorët të gjeneruara nga institucionet për muajt janar –dhjetor në vitet 2015 - 2019 dëshmon serish trend rritës.


Në krahasim me periudhën janar-dhjetor 2018, të ardhurat e gjeneruara gjatë të njëjtës periudhë në 2019 kanë shënuar një **rritje** prej **15%**.

Në krahasim me periudhën janar-dhjetor 2017, të ardhurat e gjeneruara gjatë të njëjtës periudhë në 2019 kanë shënuar një **rritje** prej **60%**.

Në krahasim me periudhën janar-dhjetor 2016 të ardhurat e gjeneruara gjatë të njëjtës periudhë në 2019 kanë shënuar një **rritje** prej **91%**.

Në krahasim me periudhën janar-dhjetor 2015 të ardhurat e gjeneruara gjatë të njëjtës periudhë në 2019 kanë shënuar një **rritje** prej **128%**.

Trendi i vizitueshmërisë gjatë muajve janar – dhjetor në vitet 2015 - 2019 sipas kategorive të institucioneve dhe qendrave të vizituara (Muze, Parqe, Monimente) është sipas grafikëve më poshtë:



Siç duket dhe në analizën e më sipërme vërehet një rritje e theksuar e numrit të vizitorëve, për rrjedhojë dhe rritja e të ardhurave nga biletat, të cilat mund të përdoren në funksion të Monumenteve të Kulturës, Parqet Arkeologjike dhe Muzetë Kombëtarë si dhe për të përballuar detyrimet për ruajtjen e objekteve apo çdo detyrim tjetër që lidhet me to.

Nisur nga sa më sipër Ministria e Kulturës kërkon dhe rritjen e limitit të përdorimit të të ardhurave nga institucionet tona. Pasi aktualisht limiti i përdorimit të të ardhurave nga institucionet është 42,500,000 lekë, ose 21% e të ardhurave të përdorshme që realizojnë këto institucione 225,839,750 lekë.

TABELA PERMBLEDHËSE PËR VIZITORËT 1 JANAR - 31 DHJETOR 2019							
Nr.	Emërtimi	Vizitorë vendas	Vizitorë huaj	Vizitorë me biletë	Vizitorë pa biletë	Totali Vizitorëve	Totali/ lekë
1	MUZEU HISTORIK KOMBËTAR TIRANË	18,349	44,606	62,955	9,658	72,613	10,421,260
2	MUZEU ARKEOLOGJIK DURRËS	2,335	13,459	15,794	3,889	19,683	4,507,500
3	MUZEU I PAVARSISË VLORE	3,617	969	4,586	433	5,019	335,000
4	MUZEU GJERGJ KASTRIOTI, KRUIJË	22,871	28,651	51,522	23,458	74,980	9,528,440
5	MUZEU ETNOGRAFIK, KRUIJË	3,057	20,221	23,278	6,842	30,120	6,857,940
6	MUZEU ETNOGRAFIK BERAT	1,450	7,485	8,935	1,711	10,646	1,634,240
7	MUZEU IKONOGRAFIK ONUFRI, BERAT	7,960	36,708	44,355	8,742	53,097	8,402,300
8	MUZEU I ARTIT MESJETAR, KORÇË,	1,395	5,895	7,290	3,481	10,771	3,762,700
9	MUZEU ARKEOLOGJIK, KORÇË,	54	375	429	1,281	1,710	85,800
10	MUZEU ARSIMIT, KORÇË,	484	66	550	1,832	2,382	45,000
11	MUZEU K. I FOTOGRAFISË MARUBI	3,627	6,409	10,036	6,040	16,076	5,312,150
12	MUZEU K. I PËRGJIMEVE * SHITËPIA M E GJETHE	3,838	11,653	15,491	5,238	20,729	9,358,000
TOTALI MUZE		69,037	176,497	245,221	72,605	317,826	60,250,330
1	KALAJA BERAT	49,784	71,118	120,902	18,656	139,558	10,966,030
2	KALAJA GJIROKATËR	26,720	68,159	94,879	20,474	115,353	17,836,740
3	KALAJA PORTOPALERMOS	13,434	15,086	28,520	470	28,990	2,852,000
4	KALAJA E KANINËS	1,000	2,920	3,920	625	4,545	392,000
5	KALAJA E HIMARËS	1,220	2,318	3,538	155	3,693	353,800
6	AMFITEATRI	586	14,867	15,453	6,364	21,817	3,079,400
7	MANASTIRI I 40 SHËNJTORËVE	419	646	1,065	135	1,200	106,500
8	MANASTIRI I MESOPOTAMIT	1,591	5,348	6,939	300	7,239	693,900
TOTALI KALA E MONUMENTE TETJERE		94,754	180,462	275,216	47,179	322,395	36,280,370
1	PARKU KOMBËTAR BUTRINT	53,906	152,492	206,398	30,325	236,723	100,963,250
2	PARKUT ARKEOLOGJIK APOLONI	13,361	30,930	44,291	15,959	60,250	13,039,220
3	PARKU ARKEOLOGJIK BYLIS	640	2,290	2,930	1,665	4,595	805,500
4	PARKU ARKEOLOGJIK SHKODËR	49,391	39,032	88,423	22,652	111,075	13,463,820
5	PARKU ARKEOLOGJIK LEZHË	1,272	1,084	2,356	2,644	5,000	225,500
6	PARKU ARKEOLOGJIK AMANTIA	200	329	529	860	1,389	104,800
7	PARKU ARKEOLOGJIK ORIKUM	1,043	1,171	2,214	1,237	3,451	427,760
8	PARKU ARKEOLOGJIK FINIQ	118	576	694	424	1,118	138,800
9	PARKU ARKEOLOGJIK ANTIGONE	229	487	716	469	1,185	140,400
TOTALI PARQE ARKEOLOGJIK		120,160	228,391	348,551	76,235	424,786	129,309,050
TOTALI NUMRI I VIZIOREVE		283,951	585,350	868,988	196,019	1,065,007	225,839,750

- **Promovimi i vlerave të trashëgimisë shpirtërore, materiale dhe diversitetit kulturor përmes zhvillimit të 70 veprimtarive të përvitshme.**

Aktivite, veprimtari kulturore

Ministria e Kulturës dhe institucionet e saj të trashëgimisë organizojnë një seri veprimtarish lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të ekspozuara in-situ ose të sjellë pranë publikut apo dhe të ekspozuara në ambientet e Ministrisë së Kulturës.

Vend shumë të rëndësishëm zënë aktivitetet e zhvilluara me mbështetjen financiare të Ministrisë së Kulturës, **Projektet me Thirrje**, të cilat përzgjidhen nga një kolegji i ngritur me urdhër ministri pas thirrjes së hapur që Ministria e Kulturës shpall për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë.

Projektet me Thirrje për vitin 2019 të trashëgimisë jo materiale janë të ndara si më poshtë:

12 të dedikuara për Programin Kombëtar “*Edukimi përmes kulturës*”;

4 Dokumentimi i vlerave të trashëgimisë; (*Dokumentarë, CD, etj.*)

4 dedikuar artizanatit;

8 festivale;

2 panaire;

7 aktivitete multikulturore;

4 inovacion.

Gratë artizane të mbështetura financiarisht ndaj totalit të përfituesve është rreth 30%.

Gjatë vitit 2019 janë zhvilluar aktivitetet:

- **“Dita e Verës 2019 Përmet-edicioni IV”**, Projekti synonte përfshirjen në tërësi të komunitetit të Bashkisë Përmet dhe në veçanti pjesën më aktive të këtij komuniteti ku përfshihen disa organizime të karakterit komunitar si Konsorciumi Pro Përmet dhe Lëvizja Sloë Food Përmet. Në këtë aktivitet u përfshinë dhe rreth 100 gra ku një pjesë e tyre shiste produktet e prodhuara vetë ndërsa një pjesë tjetër u përfshinë në organizimin e aktivitetit.

- **“Bakllamaja e Leskovikut”**. Projekti përfshinte përgatitjen dhe incizimin e 10 materialeve të vjetra popullore (8 valle e 2 këngë) dhe prodhimin e 50 copë CD-ve. Këngët popullore të grave dhe burrave (diafonike e polifonike), që këndohen në Leskovik bëjnë pjesë në nënsistemin polifonik tosk, i cili përfshin gjithë trevën e Toskërisë dhe shtrihet në Shqipërinë e Jugut, midis dy lumenjve, Shkumbinit nga Veriu dhe Vjosa nga Jugu.

- **“Mijëvjeçari i romëve : Panairi i kulturës dhe traditës rome në Qarkun e Korçës”.**

Aplikues OJF “DISUTNI ALBANIA”, Projekti kishte si qëllim promovimin e kulturës rome, prejardhjen e këtij komuniteti i cili ka ditur të ruajë vlerat kulturore, gjuhën dhe traditat.

- **“Dorë për Dore Breza Vallesh”.** Zhvillohet edicioni i parë i një festivali folklorik të minoritetit etnik grek, në javën e katërt të Prillit, ditën e festes se Pashkës se Madhe, ditë kur ka një numër të madh emigrantesh që kthehen për ta festuar këtë festë, si dhe për promovimin e vlerave të mëdha të trashëgimisë kulturore që kjo zonë bart duke e kthyer këtë krahinë në një destinacion turistik dhe vëmendje jo vetëm rajonale por edhe më gjerë. Gjithashtu synohet që këto vlera të promovohen dhe interpretohen nga brezi i ri për të mundësuar vazhdimësinë e interpretimit të tyre brez pas brezi. Ky festival u realizua për promovimin edhe më shumë të Valles së Vajzave Dropullite, e cila është shpallur *“Kryevepër e trashëgimisë kulturore shpirtërore Shqiptare”* nga Ministria e Kulturës.

- **“Pelegrinazhi i bijve të Arbërisë në Trojet Shqiptare, 26-28 prill”.** Organizuar nga CSDC Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile në bashkëpunim me Shoqatën La Svolta me qendër në Bologna/Itali dhe Shoqata Foleja Kombëtare Shqiptare me qendër në Shqipëri. U zhvillua në datat 26-28 prill në Kalatë në Lezhë, Krujë, Berat dhe Gjirokastrë. **Morën pjesë një grup prej 30 arbëreshësh.**

- **Festivali Ndërkombëtar Folklorik “Aulona Interfolk Festival”,** edicioni 11-të. Organizuar nga Shoqata Kulturore “Aulona” Vlorë, më 11-13 maj, ora 20.00 në Sheshin kryesor të Lungomares. Morën pjesë grupe popullore nga Shqipëria, Kosova, Anglia, Mali i Zi, Finlanda, Bullgaria, SHBA dhe Kroaci, **me gjithsej 300 artistë.**

- **Festivali Mbarëkombëtar i Instrumentistëve të Vegjël Popullorë,** edicioni 16-të. Organizuar nga Shoqata Eko-Turistike Pukë në qytetin e Fushë Arrëzitet më datat 17-19 maj. **Morën pjesë 100 artistë të vegjël** nga Shqipëria, Kosova, shqiptarët e Maqedonisë dhe Malit të Zi.

- **Projekti “Kthim në Vite”,** është zhvilluar si një javë e kulturës tepelenase me promovime librash, ekspozita, festival të interpretimit të këngës popullore, koncert muzikor, recitime, tryeza të rumbullakët, panair kulinarie e artizanati dhe shfaqje folklorike. **Morën pjesë 200 artistë nga të cilët 100 fëmijë, 10 artizanë, 2000 spektatorë.**

-**“Festivali Kcimi i Tropojës”,** edicioni i parë, Bajram Curri, 25-27 maj 2019. U zhvillua në sheshin kryesor të qytetit. Organizuar nga Shoqata “Kcimi i Tropojës”, Bajram Curri. Ky projekt promovoi vlerat e valles tradicionale tropojane “Kcimi i Tropojës” sidomos tek brezi i ri. **Morën pjesë 90 artistë të rinj, 900 spektatorë.**

-**“Edukimi i Fëmijëve dhe të Rinjve nëpërmjet Trashëgimisë Kulturore”** organizuar nga Shoqata “Floemi” Përmet në periudhën mars-qershor 2019. Gjatë këtij projekti u organizuan

shfaqje folklorike me nxënës të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të qytetit, vizita në objektet e trashëgimisë kulturore dhe njohja e brezit të ri me vlerat e tyre, u hap edhe një ekspozitë me piktura të punuara nga nxënësit. **Morën pjesë rreth 95 nxënës.**

-**“Instrumentistët e Rinj të Sazeve të Leskovikut”**. U zhvillua në 7 qershor në Leskovik. Projekti kishte si qëllim evidentimin e vlerave muzikore të qytetit, evidentimin e të rinjve me potencial artistik dhe konsolidimin e tyre në grupe artistike. U zhvillua një koncerte nga grupet e të rinjve pjesëmarrëse në Sheshin e Leskovikut. **Morën pjesë 43 artistë, 800 spektatorë.**

-**“Festivali Folklorik i Minoritetit Maqedonas në Shqipëri”**. Ky projekt u organizua nga Shoqata Maqedonase “Ilinden”, Tiranë. Morën pjesë Grupe folklorike Maqedonas si dhe u interpretuan këngë, valle e melodi nga pakica kombëtare maqedonase që jeton në Shqipëri e cila punon për ruajtjen dhe promovimin e kulturës maqedonase edhe tek brezi i ri që banon në zonat ku është vendosur pakica maqedonase. **Morën pjesë 100 artistë, 80 spektatorë.**

-**“Festivali i 6-të Folklorik Mbarëkombëtar i Talenteve të Rinj”**, Ky projekt kishte si qëllim promovimin e vlerave folklorike që zona e Pukës bart dhe gjallërimin e jetës kulturore artistike të zonës. Projekti u zhvillua më 6-8 qershor në sheshin kryesor të qytetit të Pukës dhe pati si objektiv rritjen e numrit të performuesve të folklorit të zonës. Gjatë zhvillimit të projektit u organizuan takime të ndryshme mes artistëve të rinj dhe shoqatave artistike, konkurrime mes grupeve pjesëmarrëse, vizita njohëse me bukuritë natyrore dhe historike të Pukës etj. Aktiviteti pati një impakt të madh tek spektatorët që e ndoqën. **Morën pjesë 100 artistë nga treva të ndryshme të vendit, 1000 spektatorë.**

- **“Festivali Përmeti Multikulturor 2019”**, Aplikues Seksioni Shqiptar i CIOFF-it. Projekti u zhvillua në Sheshin e qytetit të Përmetit më 21-23 qershor 2019. Në këtë festival morën pjesë 7 grupe me rreth **130 pjesëmarrës. Gjithsej 800 spektatorë.**

-**“Lirika në Divanin Lunxhiot”**, organizuar nga Shoqata Vizioni i së Ardhmes. Projekti u zhvillua në sheshin kryesor të Njësisë Administrative Dhoksat, Lunxhëri, më datë 21 qershor, Gjithsej artistë pjesëmarrës 150, 700 spektatorë.

- **“Edukimi i brezit të ri përmes valles tradicionale popullore”**, organizuar nga koreografi z. Bardhyl Pojani në qytetin e Korçës, në periudhën 15 mars-qershor. Ky projekt u ndoq nga rreth 300 nxënës.

- **“Digjitalizimi i Kalasë së Tiranës dhe promovimi i trashëgimisë kulturore”**. Qëllimi i projektit ishte mbrojtja, ruajtja dhe promovimi i Kalasë së Tiranës si vlerë e shtuar në trashëgiminë kulturore përmes teknologjive të reja të informacionit, duke synuar rritjen e turizmit në qytet, rinovimin kulturor të turizmit (e-tourizm).

- **“Brumi i Jetës”**, Projekti evidentoi dhe vlerësoi trashëgiminë jomateriale të riteve që lidhen me zanafillën e jetës (brumin) në ngjarjet kulmore të saj: lindja, martesja, vdekja. Projekti kishte si qëllim të sjellë në vëmendje traditën e përpunimit të drithërave, mjetet, gatimet, këngët dhe

vallet që shoqërojnë procesin. Objektivi kryesor i projektit ishte evidentimi i trashëgimisë sonë kulturore jomateriale, etnografike dhe kulinare të zonës së Gjirokastrës, nxitja e vëmendjes së artistëve popullorë për interpretime, krijimi i një databese të ideve promovuese të trashëgimisë kulturore – kulinarisë, dokumentimi i ritualit të prodhimit të brumit etj. Ky projekt përmbante ekspozitë kulinarie dhe shfaqje folklorike **Morën pjesë 10 mjeshtra të gatimit (6 femra) si dhe 90 artistë. U ndoq nga rreth 800 spektatorë vendas dhe turistë të huaj.**

- **“Edukimi i brezi i ri përmes këngës polifonike dhe valles karakteristike gjirokastrite dhe riprodhimi (qepja) e 8 kostumeve karakteristike popullore të grupit të pleqve të Gjirokastrës” edicioni i 3-të.** Vazhdimi i projektit të nisur që nga viti 2017. Edicioni i 3-të mundësoi në zgjerimin e shkollave pjesëmarrëse jo vetëm të qytetit të Gjirokastrës por dhe në Bashkitë Libohovë dhe Njësinë Administrative Ura e Kardhiqit. Ky projekt synon Edukimin përmes Trashëgimisë Kulturore Jomateriale dhe konkretisht mësimin të këngës polifonike dhe valles tradicionale gjirokastrite në 6 shkollat 9-vjeçare të Qarkut të Gjirokastrës si dhe koncerte me grupet me të mira. Gjithashtu në këtë projekt përfshihet edhe riprodhimi (qepja) e 8 copë kostume popullore tradicionale gjirokastrite burrash që sot janë zhdukur, kostumet e grupit të pleqve të Gjirokastrës, që njihet dikur si grupi i Xhevat Avdallit dhe Demir Çenkos, si një nga grupet më të mira në rang vendi, sidomos për mënyrën karakteristike të interpretimit por edhe të kostumeve tradicionale që ata përdornin. Ri sjellja e këtyre kostumeve do të sjellë promovimin e këtyre vlerave të rralla të trashëgimisë kulturore jomateriale gjirokastrite në aktivitete të ndryshme artistike

-**Projekti “Trashëgimia në shkollë: Fëmijët zbulojnë traditat e çmuara të përdorimit të veglave muzikore dhe kostumeve popullore të Shqipërisë së Veriut”.** Projekti synoi të rrisë ndërgjegjësimin e nxënësve mbi rëndësinë e trashëgimisë kulturore përmes edukimit duke u njohur me karakteristikat, tipologjinë, cilësitë dhe vlerat e kulturës muzikore veçanërisht në përdorimin e veglave muzikore karakteristike të përdorura në Shqipërinë e Veriut. Njohja e tyre u ndërthur me këngët e vallet popullore, kostumet popullore si dhe me ritet dhe festat tradicionale të zonave të Veriut, etj. Projekti ishte vazhdimësi e punës së nisur me Shkollën “Misto Mame” për të ngjallur dhe zhvilluar edukimin e ndjenjës së vlerësimit të kulturës të shprehur në elementet përbërës të veglave popullore muzikore, veshjeve popullore dhe valles popullore. Morën pjesë 50 fëmijë.

- **“Rigjallërimi i Teknikës së Punimit të Çakçirëve dhe Xhubletës”.** Organizuar nga Rita Kalaj Shkurtaç, në periudhën mars-qershor 2019 në Njësinë Administrative Bajzë, Shkodër. Ky Projekt kishte për synim mbajtjen gjallë të traditës së punimit artizanale të çakçirëve dhe xhubletës me anë të organizimit të kursit për vajza dhe gra të zonës. Kursi kishte qëllim që të mundësonte secilës grua e vajze të mësonte me detaje teknikat e punës artizanale në praktike, si puna përgatitjen e leshit, tjerren, endjen e thekeve si dhe punimin e thurjen e veshjeve. Gjatë periudhës së kursit janë përdorur edhe filmime për detaje si dhe kurs për anën teorike e duke ju shpërndarë pjesëmarrësve një cikël leksionesh. Morën pjesë 15 gra e vajza të zonës.

-**“Harta digjitale e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale”.** Aplikanti Akademia e Artit dhe Trashëgimisë – ODEA, Enkeleida Tole . U realizua në Tiranë në periudhën Mars-Korrik 2019. Ky projekt ka për qëllim krijimin e një harte digjitale/databese online të vlerave më të mira të trashëgimisë kulturore kombëtare jomateriale. Objektivat për realizimin e qëllimit kryesor të

projektit janë evidentimi, promovimi dhe edukimi i brezave të rinj me vlerat më të mira të trashëgimisë kombëtare jomateriale, hulumtimi i vazhdueshëm në këtë fushë, rritje e kapaciteteve etj. Grupi i synuar nga ky projekt janë të rinjtë, nxënës të shkollave dhe studentë, përdoruesit aktivë të internetit dhe rrjeteve sociale. Harta do të shërbejë si platformë e përhershme, e aksesueshme dhe ilustruese. Aktivitetet për realizimin e projektit janë krijimi i hartës me gjithë fazat e saj. Gjatë vitit 2018 u realizua krijimi i hartës digjitale/database online të qytetit të Përmetit. Projekti i vitit 2019 realizoi hartën digjitale/database online të qytetit të Gjirokastrës.

-Projekti “Panairi Veror Velipojë 2019”. Organizuar nga Shoqata e Artizanëve dhe Zejtarëve të Shqipërisë më 27 gusht ne Sheshin Qendror të Njësisë Administrative Velipojë. Morën pjesë 30 artizanë dhe zejtarë kryesisht nga zona veriore e Shqipërisë në 15 tryeza. Panairi promovoi punimet artizanale dhe të zejtarisë shqiptare tek turistët vendas dhe të huaj. Projekti synoi forcimin e kapaciteteve të artizanatit si një vlerë kulturore e traditës shqiptare përmes organizimit të panairove. Objektivat e projektit ishin: zhvillimi i artizanatit dhe zejtarisë nëpërmjet dizenjimit dhe krijimit të prototipave të reja artizanale, prezantimi dinjitoz i artizanatit shqiptar para turistëve vendas dhe të huaj, promovimi i aktiviteteve kulturore në zonat turistike, fuqizimi ekonomik i artizanëve përmes krijimit të mundësive të reja për shitje. Në këtë panair për herë të parë u ekspozuan edhe punime artizanale me material te riciklueshëm si dhe artizanët punonin po këto materiale punime te ndryshme.

-Projekti “Historiku i Festivaleve Folklorike të Gjirokastrës”, dokumentar. Aplikanti Valbona Zhupa, regjisore. Qëllimi i projektit është dokumentimi i një prej pasurive më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore jomateriale kombëtare, Festivaleve Folklorike të Gjirokastrës, me rastin e 60 vjetorit të themelimit të tij, për ta përshkruar si ngjarjen më madhore etnokulturore mbarëkombëtare të të gjitha trevave shqiptare. Ky dokumentar do t’i kushtohet folklorit gojor dhe muzikor, brezave të artisteve popullore, këngëtareve, valltarëve, rapsodëve, instrumentistëve, etj. që bartën, interpretuan, evoluan, trashëguan me pasion në këto 60 vjet të zhvillimit të këtij festivali. Gjithashtu do të promovojë edhe kostumet popullore tradicionale e autentike të përdorura ndër vite. Synon të promovojë këtë aktivitet në vigjilje të shpalljes së edicionit të radhës së tij dhe të zhvillimit të tij në vitin 2020.

-Projekti “ Kryeveprat të isopolifonisë të masterizuara në cd”. Aplikues Dionis Brokaj. Projekti kërkon të dokumentojë një nga pasuritë më të rëndësishme të trashëgimisë sonë shpirtërore: isopolifonisë. Objektivi kryesor i projektit është krijimi i një materiali të përzgjedhur të grupeve më të famshme, interpretimi dhe masterizimi i tyre me qëllim promovimin e FFKGJ 2020. Gjithashtu cd me këngë iso polifonike do të shërbejë edhe si një dhuratë artistike nga Shqipëria, duke qenë se isopolifonia është e njohur tashmë si pasuri e UNESCO-s

-Projekti “Teknikat Artizanale Shqiptare të endjes dhe thurjes”. Aplikanti Anila Zajmi dhe Shoqata e Stilistëve Shqiptarë. Zhvillohet në Tiranë, Lezhë dhe Shkodër. Synimi i këtij projekti është promovimi i teknikave shqiptare të endjes dhe thurjes artizanale, si pjesë e trashëgimisë kulturore shqiptare, duke hulumtuar, ekspozuar, diskutuar me grupe të gjera të shoqërisë si dhe prodhimi i mostrave më tipike të thurjes. Prodhimi i këtyre mostrave tipike të thurjes do të sjellë jo vetëm kujtesën e prodhimit tradicional të trashëguar por edhe zhvillimin e ideve sipërmarrëse duke ndikuar në pasurimin e ofertës turistike si dhe angazhimin e komunitetit

për prodhimin artizanal të tyre. Projekti konsiston në evidentimin e teknikave të endjes në zonën e Lezhës dhe Shkodrës dhe realizimin e objekteve dhe veshjeve me materiale të endura në këto teknika me një frymë bashkëkohore dhe moderne.

-Projekti Festivali Mbarëkombëtar Folklorik “Oda Dibrane”. Edicioni 25-të. Aplikant Shoqata “Oda Dibrane”, Peshkopi. U zhvillua ne dt.3-5 tetor 2019, ne qytetit e Dibrës së Madhe (date 3.10.2019), Maqedoni dhe në qytetin e Peshkopisë (4-5 tetor 2019). Oda dibrane e ka nisur jetën në vitin 1994. Ishte një iniciativë e përbashkët e artisteve dibranë dhe e Shoqatave Kulturore Artistike të shqiptarëve të Maqedonisë, Malit të Zi dhe të Kosovës qe kishin nevojë për me shume hapësira për jetën e tyre artistike. Ky festival qe nga ajo kohe vazhdon pandërprere. Këtë vit, Festivali Mbarëkombëtar “Oda Dibrane” zhvilloi edicionin e 25-te. Kjo jetëgjatësi e vazhdueshmëri ka ardhur për shkak te vlerave qe sjell. Ky projekt është mbështetur çdo vit nga Ministria e Kulturës. Qëllimi i festivalit është mbajtja gjallë e traditës dhe bashkimi i artisteve shqiptarë pavarësisht kufijve. Gjatë ditëve të zhvillimit të tij luhet kënga dhe vallja popullore humoristike tradicionale. Objektivat e festivalit janë promovimi dhe popullarizimi i folklorit mbarëkombëtar i viseve shqiptare, rritja e numrit të vizitorëve vendas dhe të huaj, gjallërimi i jetës kulturore, sjellja në skenë e traditës më të mirë dhe perfeksionimi i performancës vit pas viti etj. Target group i synuar ishin të gjitha grup moshat artdashëse. Në këtë festival morën pjese 16 grupe, ansamble dhe shoqata kulturore. Gjithashtu ne ditët e Odes dibrane u zhvillua dhe “Festa e te Vjelave” me prodhimet bujqësore e te pemëtarisë se Dibrës. E veçanta e këtij viti ishte pjesëmarrja e moshave te reja. Interesimi i publikut ishte shume i madhe, e megjithëse shfaqet shkonin mbi dy ore salla qëndronte plot.

-Projekti “Ne ruajmë trashëgiminë”. Aplikuesi Fondacioni Tradita Popullore, Edlira Sulaj. Qëllimi i projektit ishte krijimi i një Qendre artizanale, kulturore ku fëmijët e shkollave të ndryshme të përgatiten për të njohur mirë trashëgiminë kulturore shqiptare nëpërmjet artit të qëndisjes dhe thurjes. Ky projekt do të ndihmoje fëmijët e grup moshës 10-18 vjeç të njihen me teknikat artizanale të veshjes duke qëndisur, skicuar elementet tradicionale nga këto veshje duke nxitur të rinjtë për t’u përfshirë në fushën e zanateve artizanale. Morën pjesë rreth 30 fëmijë.

-Projekti “Bartësit dhe artizanët e instrumenteve tradicionalë muzikorë”. Aplikues Ermal Sela. Zhvillohet në qytetet Tiranë, Krujë, Lezhe, Pukë, Kukës, Elbasan, Berat, Fier, Korçë, Gjirokastër, Lushnje, Gramsh, Peshkopi, Gjakovë, Peje, Prishtinë Strugë, Tuz. Qëllimi i projektit është evidentimi, dokumentimi, filmimin, fotografimin, hulumtimin dhe digjitalizimi i trashëgimisë jomateriale aerofonike të trevave të Shqipërisë. Familja e veglave aerofone shqiptare (pipëza dhe derivatet e saj) janë të rrezikuara dhe drejt zhdukjes, si për sa i përket vetë veglave popullore ashtu edhe zvogëlimit të numrit të bartësve të kësaj familjeje. Ky projekt mbyllet në Muzeun Historik Kombëtar. Me materialet e marra realizohet një dokumentar si dhe botohet një katalog ku do te pasqyrohet me foto procesi i realizimit të pipëzave. Botohet gjithashtu një metodike mbi mësimin e këtij instrumenti ku do të ketë ushtrime dhe transkriptime për këtë instrument popullor.

-Festivali i Polifonisë së Luginës së Shkumbinit. Edicioni 3-të. Aplikanti Shoqata Kulturore-Artistike “ AKS” Librazhd, Haxhi Balliu. Rrethi i Librazhdit është i njohur për tradita të pasura kulturore, folklorike e etnografike. Këto tradita janë karakteristike jo vetëm me vallen dyshe e

cila kërcëhet në çdo trevë të këtij rrethi që gjendet në zonën veri-lindore të vendit, por edhe në këngën folklorike, në kostumografi etj. Objektivat e projektit janë ruajtja dhe transmetimi i këtyre vlerave, tek brezi i ri, tradita që rrezikojnë të zhduken. Organizata AKS punon në këtë fushe prej gati 20 vjetësh, me një staf të kualifikuar dhe ka zbatuar edhe projekte të tjera me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës dhe donatorëve të tjerë , ndërmer këte projekt, me qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Target grupi i synuar janë fëmijët e shkollave 9-vjecare dhe të mesme të Bashkisë Librazhd. Morën pjesë 150 nxënës.

-“Mbrojtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore dhe mjedisore në breza”. Aplikues Shoqata “Mjedis, Ujra, Pyje”, Përmet, Ali Delilaj. Qëllimi i projektit është informimi, ndërgjegjësimi, edukimi dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore dhe mjedisore përmetare ndër breza. Objektivat e projektit: të sigurohet pjesëmarrja publike në marrjen e vendimeve konkrete për ruajtjen e traditës, të sigurojë vendimmarrjen e KB, të sigurojë pjesëmarrjen e nxënësve në vendimmarrje, të ndikojë pozitivisht në shtimin e numrit të turistëve. Aktivitetet në kuadër të projektit: takime informuese, ëorkshop, aktivitete ndërgjegjësuere në shkolla, ndërgjegjësim, kthim i brezave të betonit në breza me trëndafila, Dita e Trëndafilat, kthimi i traditës së prodhimit të reçelrave, takime brezash, aktivitete promovuese. Aktivitetet janë në përputhje të plotë me qëllimin e projektit: ruajtjen, mbrojtjen dhe transmetimin e më të mirës së traditës dhe trashëgimisë. Morën pjesë 80 fëmijë.

-Projekti “Shijoni një gatim nga duart tona”. Aplikues Shoqata “Solidariteti Tani”, Përmet. Projekti i përket fushës së trashëgimisë jomateriale, më saktësisht kulinarisë. Përmes tij aplikuesi kërkon të përfshijë në jetën komunitare **fëmijët me aftësi ndryshe**, dhe njëkohësisht të ruajë edhe tradita më të mira të kulinarisë së zonës. Produktet tradicionale të gatuar nga fëmijët me aftësi ndryshe do të shiten me çmime simbolike për të gjeneruar të ardhura për ta dhe për të shpërblyer edhe financiarisht mundin e tyre. Morën pjesë 30 fëmijë.

-Projekti “ Monumentet e Kulturës Njëpërmjet Skicave”, Aplikuesi Shoqata “Albanian Society in Action”, përfaqësues Greta Prendi. Projekti u zhvillua gjatë periudhës maj-nëntor dhe kishte si objektivi kryesor edukimin e brezit të ri përmes trashëgimisë kulturore përmes garimit. Të rinjtë e interesuar në fushën e trashëgimisë kulturore përfshihen në një konkurs të skicave me karakter trashëgimimë. Skicat printohen dhe do të jenë pjesë e ekspozitave, gjatë të cilave do të ketë edhe ëorkshope për dhënien e njohurive dhe informacioneve të ndryshme. Ky projekt do të afrojë të rinjtë me trashëgimimë, do të nxisë kapacitetet e tyre krijuese me tematikë trashëgimimë, do të krijojë produkte artistike kulturore në favor të trashëgimisë kulturore dhe turizmit kulturor. Morën pjesë 30 nxënës të Shkollës së Mesme Artistike Berat.

-Projekti “Ruajtja e vlerave dhe traditave folklorike të fshatrave të zonës së Maliqit, transmetimi i tyre te brezi i ri njëpërmjet mësimimit të folklorit dhe valleve tradicionale të fshatrave të kësaj zone”. Aplikuesi Ermioni Sinollari. Qëllimi i projektit ishte edukimi përmes trashëgimisë kulturore jomateriale, konkretisht valles folklorike tradicionale të zonës së fshatrave të Maliqit. Në kete projekt organizohen mësimime të valles popullore tradicionale në shkollat 9-vjeçare të fshatrave të Maliqit dhe ato të qytetit si dhe zhvillimi i shfaqjeve të ndryshme në shkolla dhe në qytetin e Maliqit. Gjithashtu gjatë mësimimit të valleve të rinjtë njihen edhe me vlerat e kostumeve popullore të zonës. Morën pjesë 80 nxënës.

-“Muzeu Virtual “Shqipëria përmes Kartëmonedhave”. Aplikuesi SHPK Albanian Business Partner”, Julian Demeti, administrator. U zhvillua në periudhën 25 shkurt- 28 nëntor 2019, online. Qëllimi i projektit është edukimi i publikut shqiptar, në veçanti brezit të ri, me historinë e Shqipërisë përmes kartëmonedhave shqiptare duke përdorur teknologjinë.

www.kartmonedhatshqiptare.al do të shërbejë si një muze virtual duke pasqyruar kronologjikisht kartëmonedha, bono, letra me vlerë, aksione, çeqe shqiptare që prej vitit 1914 e deri me sot. Kartëmonedhat do të shoqërohen edhe me kartolina të qyteteve Shqiptare të periudhës 1900-1950 dhe një fond me kartolina ku pasqyrohen kostumet popullore të trevave shqiptare. Vizitorët do të mësojnë mbi historinë e Shqipërisë përmes imazheve në kartëmonedha. Do të mësohet pse e quajmë monedhën tonë “Lek”, pse vazhdojmë të themi në gjuhën e përditshme “lek i vjetër e lek i ri” etj.

-“Rrugët e besimit-Gjurmë Bashkëjetese” edicioni 2-të. Aplikues Endrit Shkreta, individ. U zhvillua në Voskopoje, Dhërmi, Vuno, Labovë, Berat, Delvinë, Bërnjë, Tiranë, Elbasan, Korçë, Shkodër. Ky projekt synoi të gjurmtojë vendet e kultit më tipiket dhe përfaqësueset, jo vetëm të kulturës dhe artit por edhe të bashkëjetesës fetare si një origjinalitet shqiptar. Objektivat e projektit janë: Identifikimi i vendeve të kultit me tipiket dhe përfaqësueset, realizim itinerarësh të reja turistike si “Rrugët e besimit”, dokumentim, rizbulim i vlerave të trashëgimisë kulturore, promovim i trashëgimisë kulturore, edukim përmes Trashëgimisë Kulturore. Hartohet : Database për itinerarin e ofertës turistike “Rrugët e besimit”, spote audiovizive me objektet e kultit nga Veriu në Jug, ekspozitë fotografike si dokumentim, por edhe rizbulim i vlerave të trashëgimisë kulturore, promovim në rrjetet sociale fcb, instagram, etj. Është shop me ekspert të trashëgimisë kulturore me nxënës dhe student. Morën pjesë 30 të rinj.

- “Trajnimi i brezit të ri me vlerat e trashëgimisë kulturore kombëtare për të mundësuar guida për sezonin turistik”. Aplikant Adnan Zyma. Trajnime me student, punonjës të DRTK, etj., për promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore tek vizitorët vendas dhe të huaj. Periudha prill-tetor. 30 pjesëmarrës.

-Projekti “Një valle për t’u kujtuar”, Aplikues Qendra e Shërbimeve Sociale DDAER, me përfaqësues Sueda Guri. Qëllimi kryesor i projektit të paraqitur ishte ruajtja e trashëgimisë kulturore jomateriale dhe transmetimi i saj brez pas brezi. Përmes një stafi të kualifikuar ekspertësh të folklorit dhe trashëgimisë kulturore do të përzgjidhen 5 valle përfaqësuese të spikatura të traditës së valleve në Shqipëri dhe në një hark kohor prej 5 muajsh do të trajnohen 10 çifte kërcimtarësh nga gjimnazet e Tiranës. Ky projekt shihet si një formë e edukimit të brezit të ri përmes kulturës dhe trashëgimisë. Në këtë projekt do të përzgjidhen kryeveprat e trashëgimisë dhe do të sillen pranë të rinjve për njohje dhe ushtrim. Aplikimi i valleve nga nxënësit do të xhirohet dhe do të prodhohen cd të cilat do të shpërndahen në 10 shkolla. Në mbyllje të këtij projekti do të ketë edhe event festiv për të rinjtë. Morën pjesë 20 nxënës.

- “Tradita e punimit në argjend dhe ar, traditë e artizanatit shqiptar”. Aplikuar nga Monika Hamzaraj. Periudha e zhvillimit prill-tetor, në Tiranë. Promovimi i artizanatit shqiptar në drejtim të punimit në argjend dhe ar. Morën pjesë 15 nxënës.

-Projekti “Shpirti i Ballkanit” Festivali Folklorik Ballkanik, Korçë, 24-25 maj. Në këtë festival morën pjesë grupe popullore nga Greqia, Bullgaria, Kosova, Turqia, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria. Morën pjesë 200 artistë. 1000 spektatorë.

- **Qendra Kombëtare të Veprimtarive Folklorike, sot Qendra Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale** ka zhvilluar disa aktivitete, si:

-“Festivali Folklorik Popullor i Shoqatave Kulturore”, u zhvillua në datat 18-19 prill në Sheshin kryesor të qytetit të Kavajës. Në këtë festival u përfshinë 300 artistë, bartës të folklorit nga 11 qytete të ndryshme të vendit të cilët mbajnë gjallë stilin e të kënduarit sipas traditës popullore, vallet e bukura e të larmishme, dhe lojën në instrumentet popullore. Përshëndeti këtë aktivitet Ansambli Gjilani nga Kosova. Gjithashtu gjatë ditëve të këtij festivali u organizuan edhe aktivitete të tjera shoqëruese, si një panair kulinarie me titull *“Prodhuar në Kavajë me zemër”* si dhe panairi i artizanatit ku përveç shumë objekteve u ekspozuan edhe poçet tradicionale prej balte, karakteristikë e zonës së Kavajës. Ky aktivitet u monitorua nga media lokale dhe u regjistrua nga RTSH. Gjithashtu ky aktivitet u pasqyrua edhe në rrjetet sociale. Total: 300 artistë (78 gra), 15 artizanë, 1000 spektatorë.

- “Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Valles Popullore Burimore”, u zhvillua në Sheshin kryesor të qytetit të Lushnjës, më 23-24 maj. Morën pjesë 8 grupe konkurruese dhe 2 te ftuara **me gjithsej 250 artistë**. Grupet pjesëmarrëse ishin Grupi Folklorik “Petralba” Klos, Grupi “Tradita Folklorike Kozare” Kuçovë, Ansambli “Dropulli” i Dropullit, Ansambli “Ylber mbi Kala”, Vau Dejës, Grupi i Qendrës Kulturore Dibër, Peshkopi, Grupi “As e madhe as e vogël”, Kolonjë, Grupi “10 Shqiponjat e Tërbaçit”, Vlorë, Ansambli “Sadi Halili”, Librazhd. Të ftuar ishin Grupi Folklorik “Avjerinos”, Janinë, Greqi dhe Shoqata Kulturore Artistike “Anamorava”, Viti, Kosovë. Në këtë festival u përfshinë afërsisht **rreth 200 artistë, ndër ta edhe 50 fëmijë nga mosha 10-16 vjeç**, bartës të folklorit nga zonat e sipërpërmendura të cilët mbajnë gjallë stilin e të kënduarit sipas traditës popullore, vallet e bukura e të larmishme, dhe lojën në instrumentet popullore. **1200 spektatorë**. Ky aktivitet u monitorua nga media lokale dhe u regjistrua nga RTSH. Gjithashtu u pasqyrua edhe në rrjetet sociale.

- Dita e Trashëgimisë Kulturore Kombëtare 29 shtator, Shkodër

Dita e Trashëgimisë Kulturore u kremtuan me një ndër Kryeveprat e Trashëgimisë tone Kulturore siç është Ahengu Shkodran. QKVF, në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, Qendrën Kulturore “Pjetër Gaci” u organizua në shtëpinë muze të Oso Kukës, e cila është edhe Muzeu i Shkodrës, një natë me Aheng Shkodran. Në këtë aktivitet do të jenë të ftuar jo vetëm artistët më të shquar të qytetit të Shkodrës, por edhe artistë e instrumentistë të cilët mbajnë gjallë këtë gjini të muzikës tone tradicionale. U zhvillua me datat 28-30 shtator.

-Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Iso Polifonisë, nëntor, Vlorë 2019, Festivali i Iso – Polifonisë, një festival i cili mbledh së bashku ansamble të Polifonisë Labe dhe Toske. Marrën pjesë grupe nga Vlora, Saranda, Himara, Delvina, Gjirokastra, Tepelena, Dropulli, Fieri,

Mallakstra, Berati, Skrapari, Ura Vajgurore, Gramshi, Librazhdi, Belshi dhe Korça. Festivali zgjati dy netë dhe kishte karakter konkurrues. Një juri prej tre anëtarësh vlerësoi artistët popullorë. Festivali organizohet në muajin nëntor, muaji kur Iso – Polifonia u përfshi në UNESCO, dhe u zhvillua në sallën e Teatrit “P. Marko” në qytetin e Vlorës. U zhvillua në datat 25-27 nëntor.

- Gjithashtu **Ministria e Kulturës** ka përgatitur, koordinuar, organizuar dhe monitoruar një seri aktivitesh madhore kombëtare dhe ndërkombëtare që kanë pasur në fokus promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, ndër të cilët rendisim:

- **28 shkurt – 1 mars 2019, Ministria e Kulturës bashkë-organizon** dhe merr pjesë në Samitin e Dytë të Diasporës – përgatitje e platformës së programeve televizive mbi gjuhën dhe kulturën shqipe, Sesioni/tryezë e dedikuar për kulturën dhe trashëgiminë, stendë me materiale promocionale dhe botime të MK.

- **18 prill 2019** Kremtohet “Dita ndërkombëtare e monumenteve të kulturës dhe siteve arkeologjike” me aktivitete në institucionet kombëtare të trashëgimisë kulturore

- **19 prill 2019** Platformë Virtual 3D në muze kombëtar dhe monumente të kulturës (kisha dhe xhami) falë bashkëpunimit të AKSHIT.

- **18 maj 2019** - Kremtohet “*Dita ndërkombëtare e Muzeve*” në temën: “Muzetë si qendra kulturore: e ardhmja e traditës” me aktivitete në institucionet kombëtare të trashëgimisë kulturore

- **21 maj 2019** - Kremtohet “Dita ndërkombëtare e Diversitetit Kulturor” me aktivitete në disa institucione kombëtare të trashëgimisë kulturore

- **23 maj 2019** - Inaugurohet zbatimi i projektit “Into Albania”, në kuadër të Marrëveshjes së bashkëpunimit mes MK dhe Creative Business Solutions (CBS) , financuar nga USAID me qëllim promovimin e trashëgimisë kulturore nëpërmjet platformave digjitale në muzetë kombëtarë, përfitues Muzeu Kombëtar Ikonografik “Onufri”, Berat. Është një prej projekteve në Proces për tu shtrire dhe në muzetë e tjerë;

- **24 maj 2019 - PËR HERË TË PARË**, Faqe ëeb për biletaritë elektronike për 10 qendra dhe institucione kombëtare të trashëgimisë kulturore përfituese të kësaj platforme;

- **24-28 qershor 2019** - Organizimi i ëorkshop-it “*Safeguarding of ICH and Community-based ICH Inventorying*” organizuar nga DPZHK, në bashkëpunim me Qendrën Rajonale për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jo materiale në Evropën Juglindore, nën patronatin e UNESCO-s, Sofje, Bullgari, në periudhën, i cili rezultoi në forcimin dhe përditësimin e njohurive dhe ekspertizës së punonjësve dhe aktivistëve kulturorë në nivel kombëtar lidhur me inventarizimin e TJM me bazë komunitetin, sipas Konventës së 2003, si dhe përfshirjen e Shqipërisë në hartat e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar lidhur me standardet në ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë jo-materiale.

- **5 korrik 2019** - Një nga arritjet kryesore të shtetit shqiptar në këtë kuadër është regjistrimi në listën e trashëgimisë botërore të UNESCO-s të Rajonit Shqiptar të Liqenit të Ohrit, miratuar me Vendim 43 COM 8B9 të Komitetit të Trashëgimisë Botërore në Korrik 2019.

- **29 shtator 2019** - Kremtohet “*Dita Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore*” me aktivitete në të gjithë institucionet kombëtare të trashëgimisë kulturore

- **15 Tetor 2019** Finalizimi në bashkëpunim me AADF i draftit të Planit të Menaxhimit të Integruar për Parkun Kombëtar të Butrintit, dokumenti i parë i kësaj natyre, pas miratimit të ligjit të ri të Trashëgimisë Kulturore.

- **16 tetor 2019 Platforma e shitjes së biletave elektronike përmes internetit (*Dyqani on-line*) në 10 institucione/site të trashëgimisë kulturore.** Për herë të parë në vend, funksionon dyqani on-line për 10 sitet e trashëgimisë kulturore më të vizituara në vend të cilat janë të pajisura me biletari elektronik (Muzeu Kombëtar i Fotografisë Marubi”, Parku arkeologjik, Shkodër, Muzeu Kombëtar Gjergj Kastrioti Krujë, Muzeu Kombëtar Etnografik, Krujë, Muzeu Historik Kombëtar, Kalaja e Beratit, Muzeu Kombëtar Ikonografik “Onufri”, Berat, Parku Arkeologjik, Apolloni, Kalaja e Gjirokastrës, Parku Kombëtar Butrint).

- **28 Tetor 2019** Fillon zbatimi i projektit “*Building capabilities of the Albanian public administration on free movement and fight against illicit trafficking of cultural goods*”(Ndërtimi i kapaciteteve të administratës publike shqiptare mbi lëvizjen e lirë dhe luftën kundër trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore), financuar nga programi IPA 2015 me përfitues Institutin Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (*vijon implementimi përgjatë 2020*).

- **11 nëntor 2019** Përfundon restaurimi i mozaikut në “Vila e Athinasë” në Parkun Arkeologjik të Apolonisë në kuadër të Marrëveshjes së bashkëpunimi midis MK, Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe Fondacionit Flaminia, Itali.

- **20 Nëntor 2019** Ikona “*Ringjallja e Llazarit*” e autorëve Kostandin & Athanas Zografi, pjesë e fondit të Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar, Korçë, ekspozohet në Selinë e UNESCO-s, Paris. Në ceremoninë e dorëzimit, në të cilën morën pjesë zj. Elva Margariti, MK, zj. Audrey Azoley, Drejtor i Përgjithshëm i UNESCO-s, etj. ikona u vendos në një hapësirë të dedikuar në ambientet e UNESCO-s, midis kryeveprave të tjera nga gjithë bota, duke kontribuar kështu në promovimin dhe njohjen e Shqipërisë e kulturës së saj, si dhe në prezantimin e artit ikonografik shqiptar.

- “26-27 shtator 2019” Misioni i Qendrës së Trashëgimisë Botërore/UNESCO në Tiranë "

- Dhjetorit 2019, Botimi i broshurës për Shqipërinë ne revistën holandeze "Archeologie"

- Bienale e Arkitekturës _ Venecia 2020 Maj - Nëntor 2020

- Gjithashtu institucionet e fushës në kuadër programit Edukimi përmes Kulturës, Takohemi për një libër, Arkeologu i Vogël, Miku i Monumentit, etj., kanë zhvilluar një sërë aktivitete.

Aktivitetet të zhvilluara nga IMK; QKIPK; Muzetë Kombëtarë; Parqet Arkeologjike, DRTK-të, në bashkëpunim me DAR në të gjithë vendin, si dhe janë zhvilluar një sërë aktivitetesh me nxënësit e shkollave ku pjesëmarrja e tyre ka qenë shumë e madhe.

- **Trashëgimia materiale e jomateriale e inventarizuar**
Numër objekte të regjistruara në databazën kombëtare të trashëgimisë kundrejt totalit;

Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK) në përmbushje të misionit të tij për dokumentimin e saktë shkencor të pasurive kulturore, inventarizimin, ruajtjen, katalogimin informatikë të trashëgimisë kulturore të popullit shqiptar në databazën kombëtare të pasurive kulturore, mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të pronësisë dhe të lëvizjes, me qëllim identifikimin, ruajtjen, studimin, botimin dhe promovimin e tyre, si dhe në zbatim të të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore të lidhura me të, ka hartuar dhe realizuar “Planin Operacional” duke përcaktuar objektivat dhe produktet bazuar në tre shtylla kryesore:

- A. Krijimi dhe përditësimi i Regjistrimit Kombëtar të Pasurive Kulturore përmes Sistemit Informatikë Kombëtar të Administrimit të Pasurive Kulturore
- B. Kontrolli i lëvizjeve të pasurive kulturore, mbikëqyrja dhe monitorimi i respektimit të të drejtave të pronësisë
- C. Administrimi i Bazës së të Dhënave të objekteve të humbura.

Aktivitetet të organizuara nga institucioni për periudhën: **Janar-Dhjetor 2019.**

Regjistrimi në Bazën e të Dhënave Shtetërore, “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)”, i krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.278 dt.16.05.2018 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore”.

1. Objekte të regjistruara në Bazën e të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)”, përgjatë periudhës Janar-Dhjetor 2019:

98 218 objekte në total të ndara në Institucione Publike dhe Private, :

- 96,423 objekte në posedim të Institucioneve Publike.

Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit -63

Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave -74

Instituti i Monumenteve Kulturore -1

Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë -14

Muzeu Kombëtar e Fotografisë "Marubi" -96,222 të reja dhe 4,743 të përditësuara.

Galeria Kombëtare e Arteve -28

DRKK Durrës -2

Instituti i Antropologjisë Kulturore Dhe Studimeve Të Artit -1,450 të përditësuara.

Muzeu Historik Pogradec -10

Bashkia Budapest -1

Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia e gjetheve” -8

- 1,795 objekte në pronësi Private.
- 6,193 objekte të përditësuara në RKPK.

2. Administrimi i Katalogut Kombëtar të Pasurive Kulturore, nëpërmjet sistemit informatikë kombëtar të administrimit të trashëgimisë kulturore, digjitalizimi dhe indeksimi i Regjistrave Themeltar të Fondit Muzeor Kombëtar.

- Janë digjitalizuar 24 Regjistra themeltar të fondit të Muzeut Kombëtar të Fotografisë “MARUBI”, total 16,583 faqe të digjitalizuar dhe indeksuara.
- Digjitalizuar 6 Regjistra të fondit të Institutit të Arkeologjisë.
- Digjitalizuar 21 Regjistra të fondit të Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit.
- Nga të cilët përgjatë periudhës Janar-Dhjetor 2019, janë indeksuar **140,259** objekte pjesë e fondeve të Muzeut Kombëtar të Fotografisë “MARUBI”.

3. Monitorimin e procedurave të eksportit për qarkullimin kombëtar e ndërkombëtar, të certifikuar, të pasurive kulturore të luajtshme, në bashkëpunim me institucionet doganore dhe Policinë e Shtetit.

- Periudha Janar-Dhjetor 2019, janë ndjekur praktikat lidhur me zhvendosjet e objekteve pasuri kulturore në posedim të institucioneve shtetërore dhe private.

Institucione Shtetërore

Gjithsej **1,344** objekte pasuri kulturore lëvizje/zhvendosje me qëllim ekspozim/lëvizje përhershme apo përkohshme/restaurim, brenda dhe jashtë territorit të vendit.

Brenda vendit është 1,343 objekte.

Jashtë vendit është -1objekt.

Posedues Privat - 10 objekte.

- IKRTK, në kuadër të bashkëpunimit me strukturat shtetërore, sistemin doganor, Policinë e Shtetit, ka realizuar veprimtarinë e saj përgjatë periudhës Janar-Dhjetor 2019 si vijon:
 - Procedura me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Gjirokastrë -60 objekte etnografike të sekuestruara dhe finalizuar procesi i vlerësimit.
 - Monitorimi i procedurës së zhvendosjes së 264 objekteve arkeologjike të sekuestruara nga Policia e Shtetit kaluar në fondet e Institutit të Arkeologjisë, Parku Arkeologjik Apoloni, pas Vendimit të Gjykatës.

4. IKRTK, si institucion kontribuues është përgjegjëse dhe raporton mbi proceset GPNIE, për 3 kapituj:

- Kapitulli 1, “Lëvizja e lirë e mallrave (kulturor)”.
- Kapitulli 3, “E drejta e vendosjes, liria për të ofruar shërbime”.
- Kapitulli 29, Sistemi Doganor”

5. Projekte / Marrëveshje kombëtare dhe ndërkombëtare.

- Në kuadër të implementimit të akteve të reja nënligjore në zbatim të Ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” IKRTK dhe Ministria e Kulturës, ka aplikuar dhe përfituar projektin nga IPA Kombëtare me titull “*Building capabilities of the Albanian Public Administration on free movement and fight against illicit trafficking of Cultural goods*”.

Projekti ka për qëllim përafrimin e plotë të legjislacionit vendas me Acquis of Bashkimit Evropian në fushën e luftës kundër trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore, si dhe ngritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale dhe rritjen e ekspertizës të stafeve të administratës publike shqiptare përgjegjës për implementimin e procedurave për lëvizjen e lire të pasurive kulturore dhe luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore, në përputhje me Direktivat e Bashkimit Evropian, Rregulloreve dhe legjislacionit vendas .

Projekti implementohet në Institutin Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore përgjatë vitit 2019-2020.

Projekti përcakton dy komponent, të cilat shërbejnë për realizimin e qëllimit të përbashkët në luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore:

- Përafrimi i akteve ligjore dhe nënligjore shqiptare me atë të Unionit në fushën e luftës kundër trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore dhe rishikimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Paligjshëm të Pasurive Kulturore.
- Trajnimi teknik i stafit të Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, Ministrisë së Kulturës dhe institucioneve të tjera të interesuara, përfshirë Doganat, Policinë, Interpolin dhe Prokurorinë.
- Përfitim i Asistencës teknike lidhur me një marrëveshje bashkëpunimi mes Ministrisë së Kulturës – IKRTK- SHBA, mbi importin dhe eksportin e paligjshëm dhe transferimit të pronësisë të pasurisë kulturore.
- Në proces të një Kërkesë për një memorandum mirëkuptimi ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe SHBA, në zbatim të nenit 9 të konventës të UNESCO-s 1970 “Mbi mënyrat e ndalimit dhe parandalimit të importit, eksportit të paligjshëm dhe transferimit të pronësisë të pasurisë kulturore dhe konventës mbi ligjin për aplikimin e pasurisë kulturore”.
- IKRTK, në zbatim të konventës të UNESCO-s 1970 të sipër përmendur, është në vazhdimësi procesi i rishqyrtimit të procedurave të praktikës “Ikonat” në kuadër të kërkesës së Ministrisë së Kulturës të Republikës së Maqedonisë së Veriut për disa ikona të pretenduara që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë.
 - Shqyrtimi i praktikës, verifikimi fizik i objekteve në terren.
 - Përgatitja e raportit përfundimtar.
- IKRTK në kuadër të marrëveshjeve kombëtare referuar këtu Paktit për Universitetin.
 - Marrëveshje bashkëpunimi Nr. 800 Prot. Dt. 08.10.2019 mes Ministrisë së Kulturës, IKRTK dhe Universitetit të Arteve.

- Duke përfshirë dhe angazhuar studentët e Universitetit të Arteve të asistojnë në procedurat e ndjekura nga IKRTK në zbatim të ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” lidhur me, njohjen e Institucionit, përgjegjësit e IKRTK-së dhe Bazës e të Dhënave Shtetërore, “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)”, funksionet si dhe ndërlidhjet e saj.

3. Programi ”ART DHE KULTURA”

Ky program ka qëllim edukimin, zhvillimin dhe promovimin e skenës artistike dhe vlerave kulturore kombëtare dhe ka objektivi rritjen e interesit të publikut ndaj programeve kulturore përmes përmirësimit të shërbimeve në infrastrukturë si dhe rritjen e cilësisë artistike.

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë:

në 000/lekë

Gr.	Programi	Artikulli	Emertimi	Plani 12 mujorit 2019		Realizimi 12 mujorit 2019		Realizimi ne (%) ndaj Planit perfundimtar te vitit 2019
				Ne mije leke	Struktura ne %	Ne mije leke	Struktura ne %	
12	08230	600-601	Shpenzime Personeli	508,959	33.59%	504,936	34.62%	99.21%
12	08230	602-606	Shpenzime Korrente	286,041	18.88%	236,078	16.19%	82.53%
12	08230	230-231	Shpenzime Kapitale	720,000	47.52%	717,488	49.19%	99.65%
		Totali		1,515,000	100%	1,458,502	100%	96.27%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 96.27% ndaj planit për 12-mujorin e 2019. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 33.59% të totalit dhe janë realizuar në masën 99.21% ndaj planit vjetor 2019. Shpenzimet korrente zënë rreth 18.88% të totalit dhe janë realizuar në masën 82.53% ndaj planit vjetor. Ndërsa shpenzimet kapitale zënë rreth 47.52% të totalit dhe janë realizuar në masën 99.65% ndaj planit vjetor.

Gjatë monitorimit 12-mujor Ministria e Kulturës ka evidentuar gjithashtu realizimin e qëllimeve, objektiveve nëpërmjet treguesve të performancës të planifikuara nga ato të realizuara në fakt sikurse prezantohet në mënyrë të detajuar më poshtë:

Kodi i Programit	08230	Emertimi i programit:	Arti dhe Kultura						
			**Treguesit e performancës/Produktet:						
		Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar ne vitin korent	Niveli i planifikuar per periudhen progresive	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit
Qellimi i politikës									
Qellimi 1	Edukimi, zhvillimi dhe promovimi i skenës artistike dhe vlerave kulturore kombetare								#DIV/0!
			Rritja e numrit te aktiviteve te edukuese, artistike dhe promovimi i vlerave kulturore kombetare	3%	5%	4%	4%	4%	100%
			Rritja dhe zhvillimi i audiencave ne funksion te mbrojtes se krijtarise dhe cilesise artistike	3%	4%	4%	4%	4%	100%
Objektivat e politikës:									
Objektivi 1	Rritja e interesit te publikut ndaj programeve kulturore permes përmirësimit të shërbimeve në infrastrukturë si dhe rritjen e cilësisë artistike.								#DIV/0!
			Objekte të rikonstruara - Ne Institucionet e art kultures.	1	1	1	1	1	100%
			Aktivite nga kalendaret artistik të zhvilluara nga Institucionet qendrore publike te art - kultures	1,500	1,500	1,400	1,400	1,367	98%
			Aktivite artistike duke respektuar barazine gjinore ndaj totalit të mbështetur financiarisht nga MK (projekte me thirrje).	72	90	80	80	80	100%
			Rritja e punesimit me kohe te pjesshme për Artistët e rinj pjesëmarrës në shfaqje dhe aktivite kulturore brenda vendit	2%	5%	3%	3%	3%	100%
			Ritja e audiencave dhe edukimi i masave permes atelieve artistike prane institucioneve te varesise dhe nga grupet e interesit.	430	500	650	650	657	101%
			Shtirja gjeografike e aktiviteve artistike në funksion të turizmit kulturor	2%	5%	5%	5%	5%	100%
			Ngritja e kapaciteteve ne funksion te programeve te edukimit kulturor krahasuar me nje vit me pare	4%	6%	5%	5%	5%	100%
			Nxitja e konkurrencës artistike përmes audicioneve dhe konkurimit publik krahasuar me nje vit me pare	3%	10%	5%	5%	5%	100%
			Perfaqesime nderkombetare elitare jashte vendit edhe ne mbeshetje te diaspores shqiptare.	55	60	50	42	42	100%

Fondet buxhetore janë realizuar si më poshtë:

Produkti: Investime të reja të skenave teatrore bashkëkohore

Në lidhje me Investimet dhe ndërtime të reja të skenave bashkëkohore, rikonstruksione infrastrukturore në nivel qendror dhe vendor në institucionet e artit dhe kulturës si dhe hapësira të reja rikualifikimi;

- Rikonstruksioni i Teatrit të Operës dhe Baletit, në përfundim procesi.

Produkti: Veprimtari të realizuara me institucionet e art-kulturës

Bazuar në objektivin 4 vjeçar të PBA, për rritjen e interesit të masave ndaj programeve kulturore dhe industrive krijuese duke përmirësuar shërbimet në infrastrukturë si dhe rritjen e cilësisë artistike, shprehemi për një trend rritës të këtyre aktiviteve. Drejtorja, koordinon dhe përpunon

të dhënat statistikore mujore, për nr. e premierave, shfaqjeve, projekteve, audiencës për këto institucione, të cilat i raporton edhe në rrugë zyrtare pranë KM dhe INSTAT.

Një tjetër sfidë dhe prioritet institucional i Ministrisë së Kulturës, ku **Kultura** nuk është vetëm një plotësim shpirtëror por një domosdoshmëri e përditshme e të rinjve dhe audiencave të gjera. Investimet kulturore po vijnë të kenë prioritet në rikualifikim dhe rikonceptim të institucioneve qendrore të artit dhe kulturës, që synojnë të ndikojnë drejtpërsëdrejti në rritjen e cilësisë së jetës dhe në edukimin e grup moshave të ndryshme. *Edukimi masiv* me art e kulturë synon ndërhyrjen në kurrikulat e shkollës nga njëra anë, duke përfshirë në çdo institucion arti linjën pedagogjike dhe edukative nga ana tjetër.

Edukimi artistik konsiderohet si një nga politikat më të rëndësishme duke e vënë theksin gjithmonë dhe më shumë në vëmendjen që i duhet kushtuar kësaj politike që ndikon jo vetëm në përmirësimin e statusit të jetesës të çdo pjesëtari në komunitet, por veçanërisht edukimit cilësor nga brezi i më të vegjëlve e përgjatë gjithë edukimit arsimor, të cilët do të jenë edhe konsumatorë të produktit artistik në të ardhmen. Në vendin tonë institucionet qendrore të artit zotërojnë kapacitetet e duhura që garantojnë institucionalizimin e kësaj politike, duke sjellë dhe përfitime të dyanshme në lidhje me angazhimin e artistëve dhe profilin artistik në këto institucione kundrejt përfitimit të produktit artistik direkt në interes të brezit të ri.

Prioritet Qeveritar- Dokumenti: “Pakti për studentët”.

Marrëveshje Kuadër e lidhur ndërmjet palëve:

- Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Republikës së Shqipërisë
- Universiteti i Arteve në Tiranë
- Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim – Zyra Tiranë
- Gazsjellësi Trans Adriatik AG, me objekt:

“Kryerjen e Studimit të Fizibilitetit dhe projektin e zbatimit për Restaurimin dhe Rikonstrukcionin e Sallës së Koncerteve në Universitetin e Arteve në Tiranë”.

Pakti për Universitetin, për vitin 2019 u zhvillua për herë të parë me qëllimin e plotësimit të angazhimeve të identifikuar gjatë procesit të dialogut për të krijuar zgjidhje më të mira brenda fokusit të fushës së veprimit të palëve. I cili pritet të sjellë progres në fushën e artit dhe kulturës duke promovuar kapacitetet e reja krijuese dhe artistike.

Ministria e Kulturës gjatë këtij viti arriti të nënshkruaj marrëveshje KUADËR të bashkëpunimit mes MK dhe Universitetit të Arteve, datë 08.05.2019, nr 3018 prot, për Implementimin e Dokumentit "Pakti për Studentin", procesi që vijoi me 8 nën-marrëveshjet sektoriale si me:

- Galerinë Kombëtare të Arteve;
- Teatrin Kombëtar;
- Teatrin Kombëtar Eksperimental Kujtim Spahivogli;
- Qendra Kombëtare Kulturore për Fëmijë Teatri i Kukullave,
- Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit;
- Teatri Kombëtar i Operas Baletit dhe Ansamblit Popullor;

- Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore;
- Qendra Kombëtare e Kinematografisë
- Pritet realizimi i marrëveshjes midis MK –IMK/ dhe Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës;
- Është nënshkruar i urdhri i përbashkët datë 23.07.2019 midis MAS dhe MK “Për përcaktimin e shërbimeve të ofruara dhe çmimeve të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit në fushën e artit dhe kulturës”

Produkti: Veprimtari të realizuara me fondet e programit ART-KULTURË

“Krijimtaria artistike dhe industrinë kulturore”: Ky produkt vjen si rezultat i mbështetjes së projekteve në dy drejtime:

Projekte me thirrje: ART-KULTURA: Për vitin 2019 janë vlerësuar dhe mbështetur nga Kolegjiumi, në përbërje të tij me titullar nga MK dhe ekspert të fushës, **rreth 111 projekte fituese** nga Ministria e Kulturës, me një vlerë Totale prej 51.360.000 lekë. Nga këto **106 projekte të realizuara 100%**, pasi 5 prej projekteve fituese janë tërhequr nga thirrja. Numri total i shprehjes së interesit ishte: 320 projekte konkurruese në aplikim.

Vizioni i program-thirrjes u bazua në mbështetjen e projekteve dhe programeve që investojnë në rezultate të qëndrueshme dhe afatgjata në rritjen e të punësuarve në sektorin e kulturës, që promovojnë dhe integrojnë burimet dhe potencialet kulturore, të konsoliduar me përvoja të suksesshme në partneritete publike private dhe ndërkombëtare, për të arritur benefitet e dëshiruara sociale, ekonomike dhe edukimit kulturor në Shqipëri.

Fondi i Ministrisë së Kulturës në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore, mbështeti ato **projekt- propozime që kishin fokus:**

- Platforma dhe programe të edukimit përmes artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore;
- Platforma dhe projekte në funksion të turizmit kulturor;
- Platforma dhe projekte që punësojnë dhe angazhojnë numër të lartë të artistëve apo subjekteve që lidhen me kulturën;
- Projekte kulturore inovative - digjitale;
- Projekte të industrive kreative

Lista e projekteve me thirrje:

1. Subjekti “Albania Dance Meeting”, për projektin “Albania Dance Meeting”;
2. Subjekti “Institute of Cognitive Behavior Terapy”, për projektin “Arti në sytë e fëmijëve”;
3. Subjekti “Zumba”, për projektin “Open Festival on tour”;
4. Subjekti “Tirana Film Institute”, për projektin “TIFF 2019-Edicioni XVII & TIFF Kids”;
5. Subjekti “TunnelFilm”, për projektin “Tourismovie 100”;
6. Subjekti “Orafilm Marubi”, për projektin “Festivali Ndërkombëtar i Filmit për të Drejtat e Njeriut”;
7. Subjekti “Bind”, për projektin “Tirana 48 Hour Film Project- Edicioni 10”;
8. Subjekti “First Step Association”, për projektin “Korça Short Film Festival”;

9. Subjekti “Anifest”, për projektin “A-FestFilm Rozafa 2019”;
10. Subjekti “Multi Media Studio Nositi”, për projektin “Dea Open Air”;
11. Subjekti “A.R. Production”, për projektin “Balcan's Gate”;
12. Subjekti “Fondacioni EDS”, për projektin “Festivali i Filmit, Muzikës dhe Kulinarisë”;
13. Subjekti “Community Development Centre-CDC-Albania”, për projektin “Festivali Mbarëkombëtar i Komedisë "Koko Fest"”;
14. Subjekti “Qendra Kombëtare e Teatrit Mesdhetar”, për projektin “Butrinti Summer Festival”;
15. Dhimitraq Orgocka për projektin “Festivali Ndërkombëtar i Monodramës Albamono 2019”;
16. Subjekti “Shoqata Europiane e Teatrit Bashkëkohor Shqiptar A.T.K”, për projektin “Festivali XXI Ndërkombëtar Teatror Kontemporan SKAMPA 2019”;
17. Subjekti “DoART”, për projektin “Festivali i Artistëve të Rrugës Në Radio”;
18. Subjekti “Çajka”, për projektin “Festivali Mbarëkombëtar i teatrit profesionist "Kadri Roshi””;
19. Subjekti “Klaus Film”, për projektin "International Puppet Theatre Festival Albania Butterflies”;
20. Ardita Shala për projektin “Atdhe në Kulturë”;
21. Besjana Cegrani për projektin “Autentic”;
22. Subjekti “Dora e Pajtimit”, për projektin “ALB komik”;
23. Subjekti “M.AM”, për projektin “Për-Pjekje me të kaluarën”;
24. Subjekti “ARTLINK”, për projektin “Krime të Vogla Bashkëshortore”;
25. Subjekti “ART BLU”, për projektin “Shfaqje artistike musical "Annie””;
26. Laert Vasili, për projektin “Çështja e rrugës Lursin”;
27. Shkëlzen Berisha, për projektin “Unë Jam Vetë Gruaja Ime”;
28. Amos Zaharia, për projektin “Historia e një ushtari”;
29. Subjekti “Different Trains”, për projektin “Different Trains Festival”;
30. Subjekti “Njerëz dhe ide”, për projektin "Music International of Korça –“MIK” Festival”;
31. Subjekti “ARTPLUS”, për projektin “Festivali Multikulturor Berat, Edicioni VI, 2019”;
32. Subjekti “Shpirti Artistik i Shkodrës”, për projektin “Festivali I 57-të Mbarëkombëtar i Këngës për Fëmijë”;
33. Subjekti “Artistët Interpretë”, për projektin “International Albanian Brass Festival 4”;
34. Subjekti “Gjenerata e Re”, për projektin “Festivali i Pejsazheve Muzikorë”;
35. Subjekti “SinfoArt”, për projektin “Tinguj Kinemaje”;
36. Subjekti “Turtle Fest”, për projektin “Turtle Fest”;
37. Subjekti “Skampa”, për projektin “Takim Mbarëkombëtar i Orkestrave të Harqeve Muzika e Dhomës dhe Krijimtaria e saj”;
38. Subjekti “Syri Blu”, për projektin “International Festival Jazz in Albania & Eorld Music Edicioni VIII”;
39. Subjekti “Arti dhe Kultura Italo Shqiptare”, për projektin “Festivali Ndërkombëtar i Muzikës së Dhomës”;
40. Subjekti “Qendra Tirana 20”, për projektin “NYOU Festival”;

41. Subjekti “Shoqata Kulturore Rrok Jakaj”, për projektin “Shkodra Jazz Festival”;
 42. Subjekti “Vox Baroque”, për projektin “Festivali Ndërkombëtar i Muzikës Baroke Vox Baroque - Edicioni VI”;
 43. Subjekti “Kulturë Media Art”, për projektin “Festivali Marie Kraja”;
 44. Takuina Adami, për projektin “Festivali Mbarëkombëtar i Zërave të Rinj "Jorgjia Truja”;
 45. Subjekti “Miq Për Jetë”, për projektin “Rrugëtim Bach”;
 46. Kastriot Tusha, për projektin “Kastriot Tusha dhe Egnatia Ensemble në turne”;
 47. Gëzim Belegu, për projektin “Midis Tingujve dhe Historisë”;
 48. Denis Bizhga, për projektin “Albania Guitar Festival”;
 49. Subjekti “RIAS”, për projektin “Ëndrra e Gjon Milit”;
 50. Subjekti “Partizani Production”, për projektin “Rock the Castle”;
 51. Klevis Gjergji, për projektin “Koncertet e Prillit”;
 52. Petrika Backa, për projektin “AME Klarinet”;
 53. Thoma Simaku, për projektin “Tirana Composition Academy 2019”;
 54. Dritan Gani, për projektin “Da Vinci 500”;
 55. Dren Abazi, për projektin “Dren Abazi and Synphonic Orchestra”;
 56. Subjekti “Instituti i Artit Bashkëkohor Tiranë - TICA”, për projektin “Programi i Rezidencave AIR-Lab”;
 57. Subjekti “ZETA”, për projektin “Çmimi Ardhje”;
 58. Subjekti “Consulting and Development Partners - CODE”, për projektin “Art House 2019”;
 59. Subjekti “Krisiko Art Studio”, për projektin “CERAmix - Cilësi edukimi përmes Rekreacionit dhe Artit”;
-
60. Subjekti “VizArt”, për projektin “Bienalja e 3-të Ndërkombëtare e Akuarelit”;
 61. Subjekti “Bazament”, për projektin “Tre solo nga tre artistë shqiptarë”;
 62. Giada Kuka, për projektin “Të Rinjtë, Arti dhe Muzeu”;
 63. Perikli Çuli, për projektin “Universi, Një Ide Monumentale”;
 64. Isida Plumbi, për projektin “Edukimi përmes Kulturës dhe Artit të Fotografisë”;
 65. Adnan Beci, për projektin “Connected by Egnatia- Rruga e Karvanëve 2”;
 66. Subjekti “DMO Albania”, për projektin “Tirana Foto Festival 2019”;
 67. Subjekti “Instituti i Bashkëpunimit për Integrim dhe Zhvillim - ICID”, për projektin
 68. “Platforma e Hartës Digjitale të Artistëve Shqiptarë”;
 69. Subjekti “Bota Ndryshe”, për projektin “Turi Virtual i Monumenteve Kulturore”;
 70. Subjekti “Meg Art”, për projektin “Musical Moulin Rouge”;
 71. Subjekti “Art-Im-Pulse”, për projektin “Festivali i Filmit Ballkanik dhe Artit Kulinar”;
 72. Artan Imami, për projektin “Janë gjëra që ndodhin”;
 73. Subjekti “Shoqata e Botuesve Shqiptarë”, për projektin “Panairi i Librit "Tirana 2019"”;
 74. Subjekti Shoqata “Durana”, për projektin “Panairi i Librit 'Durrës script’”;
 75. Subjekti “Fondacioni Harpa”, për projektin, “Panairi i Librit "Fieri 2019"”;
 76. Subjekti “Instituti i Librit dhe Promocionit”, për projektin “Festivali Letrar për të rinj, ed. V”;

77. Subjekti “Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë”- IDMC, për projektin “Tirana lexon 2019”;
78. Subjekti Shtëpia Botuese "Dritëro", për projektin “Festivali Ndërkombëtar i Librit "Fije bari”;
79. Subjekti “Akademia Kult”, për projektin “Çmimet Kult 2019”;
80. Subjekti Shtëpia Botuese “Toena”, për projektin “Çmimi letrar për romanin më të mirë të Ballkanit 2019”;
81. Alda Bardhyli, për projektin “Letërsia dhe qyteti”;
82. Monika Stafa, për projektin “Ditët e letërsisë për fëmijë”;
83. Subjekti “Liburnetik”, për projektin “Biblioteka, arti dhe të rinjtë”;
84. Subjekti Klubi i Shkrimtarëve "Naim Frashëri" Përmet, për projektin “Në gjurmët Naimiane 2019”;
85. Arta Marku për projektin “Agora”;
86. Orjana Osmeni, për projektin “Alb Babel”;
87. Subjekti “Mediaprint” shpk, për projektin “Trashëgimia dhe arti në duart e fëmijëve”;
88. Subjekti “Albas” shpk, për projektin “Udhëtim në trashëgiminë kulturore të qyteteve shqiptare”;
89. Subjekti “Universiteti Metropolitan Tirana”, për projektin “Promovimi i të lexuarit në gjimnazet e Tiranës”;
90. Subjekti “Albanian Innovation Foundation”, për projektin “Biblioteka Digjitale”;
91. Agim Baçi, për projektin “Të njohim letërsinë bashkëkohore shqiptare”;
92. Edvina Dede për projektin “Pass Port-Letra në kuti”;
93. Subjekti “Qendra UET”, për projektin “Ditët Letrare në Razmë”;

94. Subjekti "Qendra STEPS”, për projektin “Edukim përmes artit social”;
95. Ardian Ndreca, për projektin “Studime bashkëkohore albanologjike”;
96. Astrit Fani, për projektin “Liria fillon me fjalën-më lejo të flas”;
97. Luljeta Lleshanaku, për projektin “Sabbat 2019”;
98. Subjekti Shtëpia Botuese “Dituria”, për projektin “Përvoja e përkthimit nga letërsia më e mirë evropiane”;
99. Subjekti Shoqata “Poeteka”, për projektin “Poeteka 2019”;
100. Petrit Palushi, për projektin “Botim i veprës të Sabajeta Peposhit”;
101. Sadik Spahija, për projektin “Nën trysni”;
102. Subjekti Shtëpia Botuese “Fan Noli”, për projektin “Poezi nga sirtari, të Robert Priftit”;
103. Subjekti “Shoqata e Koleksionistëve Shqiptarë”, për projektin “Emetimi i numrave 33/2019 dhe 34/2019 të revistës "Koleksionisti”;
104. Subjekti “Shejzat Pleiades”, për projektin botimi i “Revista “Shejzat”;
105. Prendë Palnikaj, për projektin “Nikajt dhe Mërturi në shekuj”;
106. Subjekti “REK Remont Kapital” për projektin “Fustanella”;

Me qëllim arritjen e objektivave si:

- Rritja e interesit të masave ndaj programeve kulturore dhe industrive krijuese përmes përmirësimit të shërbimeve në infrastrukturë si dhe rritjen e cilësisë artistike;
- Rritja e numrit të aktiviteteve sensibilizuese / edukuese, artistike përmes promovimit të industrive krijuese në rang vendi.
- Rritja dhe zhvillimi i audiencave në funksion të mbrojtjes së krijimtarisë dhe cilësisë artistike duke respektuar genderin dhe të drejtat e njeriut;
- Mbështetje e industrive krijuese duke respektuar barazinë gjinore, të drejtat e njeriut, grupet e marginalizuara dhe diversitetin kulturor në rang vendi. (projekte me thirrje).
- Rritja e punësimit me kohë të pjesshme për Artistët e rinj (Studentë), të angazhuar në shfaqje dhe programe kulturore në rang vendi. (Pakti i studentit)
- Rritja e audiencave, sensibilizimi dhe edukimi i masave përmes industrive krijuese dhe atelieeve artistike në institucionet e varësisë dhe nga skena e pavarur.
- Shtrirja gjeografike e fushatave sensibilizuese dhe aktiviteteve artistike në funksion të turizmit kulturor në rang vendi. projekti (100 fshatrat) +kalendarët artistik (aparati-institucione varësie).
- Ngritja dhe aftësimi kapaciteteve njerëzore në funksion të programeve edukimit përmes kulturës krahasuar me një vit më parë.
- Nxitja e konkurrencës artistike përmes audicioneve dhe konkurrimit publik krahasuar me një vit më parë.

Projekte të brendshme: ART-KULTURA:

Drejtorja, ka udhëhequr dhe ka hartuar për 12 mujorin e vitit 2019, **28 praktika brenda vendit +10 praktika ndërkombëtare** - projekte të posaçme në kuadër të prioritetëve strategjike për Ministrinë e Kulturës si dhe kalendarëve dhe bashkëpunimit kulturor në nivel institucional dhe ndërinstitucional;

Brenda vendit:

1. “Dy ditë në fshatin tim” në fshatin Kuç, qarku Vlorë, 2019.
2. Organizimi i Muajit të Muzikës” 2019, në kuadër të promovimit të Muzikës Shqiptare.
3. Festivali i Bashtovës, 2019;
4. 10 Tenorët, botëror nga 5 kontinente, në vijimësi të Koncertit Tre Tenorët;
5. Balet në akull, nëntor 2019;
6. Mbrëmë i pëshpërta një ylli
7. Transition dhe Kids në TIFF 2019”.
8. Krijimtaria për Fëmijë, me shpalljen e 5 fituesve në edicionin e viti 2019
9. “Mos Harro Librin e Verës” në bashkëpunim me QKKFTK
10. Çmimet Kombëtare të Letërsisë
11. Fondi i përkthimit nga gjuha shqipe në gjuhë të huaj
12. Tetori i Librit
13. Elton Deda - Koncert “Tre muskultierët”

14. 75 Vjetori i Çlirimit
15. Botim I librit “Historia e mendimit shqiptar”- Ndriçim Kulla;
16. Muzeu i Stilit, Ethno Vibe”, Hani i Pazarit, Korçë.
17. “Janaq Paço” – Skulptori Popullit – Botimi i Veprave katalog.
18. Konkursi Kombëtar, per realizimin e “logos” së 75-Vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë, 2019;
19. “Be Different”, pjesëmarrja e koreografit Eltion Merja, në festivalin e kërcimit “Sibernik Dance Festival”, Kroaci;
20. Stil & Modë” , Stilitja Mirela Nurçe, pjesëmarrje në javën e modës, Milano, Itali;
21. Ekspozitë e artistit Lek Gjeloşi, , në Stacion – Qendër, Prishtinë, Kosovë;
22. Za-Festival”, zhvilluar në fshatin Theth, Shkodër;
23. “Transition 2019, në Tiranë;
24. Luz Casal/Koncert”, në Amfiteatrin e Tiranës;
25. “Koncert Solistik, Violinë”, i artistit Silvester Shoshi
26. “E Lucevan Le Stelle”, Koncert Recital i Tenorit Armaldo Kllogjeri, Tiranë; “America The Beautiful”, Koncert Recital i Tenorit Kastriot Tusha, Tiranë;
27. “Trio Në 2 Ditë në Bjeshkë”, realizuar përgjatë Liqenit të Komanit dhe Bjeshkët e Valbonës në Shqipëri.
28. TIFF-Rënia e murit të Berlinit

Produkt : Përfaqësime në programe dhe evenimente ndërkombëtare

1. Panairi i Librit “Torino 2019”, Itali;
2. Festivali Ndërkombëtar i Letërsisë, në Mantova, Itali 2019;
3. Panairin Ndërkombëtar të Librit në Lajpcig, Gjermani 2019;
4. Përfaqësimi i Shqipërisë në Edicionin e 58-të Bienales të Artit së Venecias, Itali;
5. Përfaqësimi i filmit franko-shqiptar “The Van”, në Festivalin e Kanës, Canne, Francë;
6. Pjesëmarrja e Artistit Erind Bajo, në Konkursin “Forum Gitarre Eien 2019”, në Vjenë-Austri;
7. Përfaqësimin ndërkombëtar, të shfaqjes artistike “**Unë kam gjithmonë një shami në xhepin tim**”, në Festivalin e kërcimit në Pekin, Kinë;
8. Ekspozitë e artistit shqiptar Adrian Paci, në Kunsthalle Krems, Austri;
9. “European Fashion Passport”, pjesëmarrëse artistja shqiptare Erola Cela (studente e dizajnit në UART).
10. “Sorkadhet e Trembura - Filmi Gjirokastra”; i autorit Ismail Kadare, në proces realizimi.

Prioritetet për vitin 2020:

- **Investime të reja të skenave teatrore bashkëkohore**

- Rikonstruksioni i Teatrit të Operës dhe Baletit. **Inaugurimi 2020**

- Restaurimi, Rikonstruksioni dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (MKAB)-(Galeria Kombëtare e Arteve). **Fillon 2020**

Ka filluar puna për konceptimin e tri projekteve për investim kapital me vendndodhje në Tiranë, të cilat janë:

- rikualifikim dhe ri konceptim të Muzeut Historik Kombëtar; **Fillon 2020**
 - rehabilitimi i godinës së Galerisë Kombëtare të Arteve dhe transformimin e saj në Muzeun e Artit si një qendër e rëndësishme e historisë së artit shqiptar. **Fillon 2020**
 - ri konceptimin e godinës së Teatrit Kombëtar, në një nga objektet me infrastrukturë më moderne të fushës bazuar në drejtimet bashkëkohore. **Fillon 2020**
- **Veprimtari të realizuara me institucionet e art-kulturës**

Kalendarët artistik të 7+1 QKL institucioneve qendrore të artit dhe kulturës, Qendra Kombëtare e Librit është institucioni më i ri me fokus : *Mbështetjen e botimeve të librit dhe revistave në fushën e letërsisë dhe shkencave shoqërore, si dhe Përkthimeve të veprave të autorëve shqiptarë në gjuhë të huaja dhe prezantime të letërsisë shqipe në nivel ndërkombëtar.*

Veprimtari të realizuara me fondet e programit art-kulturë

Libri:

- Fondi i përkthimit nga gjuha e huaj në gjuhën shqipe
- Fondi i përkthimit nga gjuha shqipe në gjuhë të huaj
- Fondi i Bibliotekave
- Tetori i Librit
- Çmimet Kombëtare të Letërsisë
- Krijimtaria Letrare

Artet e bukura –Filmi-Muzika-Teatri-Dance- Artet vizive-arkitekturë-trashëgimi kulturore-industria krijuese/inovacioni

- Pakti për Universitetin

Artet e aplikuara vizive

- “Mbi Ngritjen e Kapaciteteve Kreative dhe Kulturore”
- **PAVIJONI** “*Art në Institucionet Publike*”

• **Përfaqësime në programe dhe evenimente ndërkombëtare**

- Kalendar i skenës ndërkombëtare prestigjioze dhe kalendar i Diasporës
- Panairi Leipzig
- Panairi i Torinos
- Bienale e Artit bashkëkohor Venecia 2020- 2021
- EXPO Dubai 2020
- Kalendar Shqipëri-Kosovë
- Rezidenca e Salsburgut/Austri
- EMC/Forumi mbi muzikën ndërkombëtare
- Aderime në programe komunitare në funksion të Edukimit Kulturor dhe Industrive Krijuese
- IPA III

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

